



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Drejtësia e vonuar në Kosovë



Autorët: Mirvet Thaqi dhe Driton Nocaj

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Dhjetor, 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive	5
2. Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm kohor sipas standardeve të GjEDNj.....	7
3. Jurisprudenca e GjEDNj në zbatimin e standardit për gjykim brenda afatit të arsyeshëm....	8
4. Standardi i gjykimit në afat të arsyeshëm dhe kohëzgjatja e gjykimeve sipas rendit juridik kosovar	9
5. Gjykata Kushtetuese dhe kërkesat e ushtruara për shkelje të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.....	10
6. Ankesat e qytetarëve tek Avokati i Popullit sa i përket zvarritjes të lëndëve gjyqësore	11
7. Përgjegjësia e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në procedimin efikas të proceseve gjyqësore	12
8. Mungesa e mjetit efektiv juridik në legjislacionin vendor kundër zvarritjes së gjykimeve	14
9. Roli i CEPEJ-it për të përmirësuar menaxhimin efikas të proceseve gjyqësore.....	15
10. Ngarkesa me lëndë e gjyqësorit si faktor që ndikon në zvarritjen e procedurave gjyqësore	16
11. Ngarkesa dhe efikasiteti i gjykatave themelore me lëndë për periudhën 2018-Qershor 2021	17
11.1 Ngarkesa dhe efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve DP për periudhën 2018 – qershor 2021	18
11.2 Trendi i zgjidhjes së lëndëve nga DP e GjTh-ve.....	19
11.3 Ngarkesa me lëndë të krimeve të rënda (DKR) në gjykatat themelore 2018 – qershor 2021 ...	22
11.4 Trendi i zgjidhjes së lëndëve DKR për periudhën 2018-qershor 2021	22
11.5 Ngarkesa me lëndë civile në gjykata themelore dhe degë për vitet 2018 - qershor 2021	24
11.6 Trendi i procedimit me lëndë civile për periudhën 2018-qershor 2021	25
12. Ngarkesa dhe efikasiteti me lëndë i Gjykatës së Apelit për vitet 2018-qershor 2021	27
13. Shtyrja e seancave gjyqësore tek raste penale, civile dhe krime të rënda.....	31
14. Ping-pongu me lëndët gjyqësore zvarrit pa arsye procedurat gjyqësore	33
12. Analiza e kohëzgjatjes së gjykimeve në themelore e Apel, në DP, DC dhe DKR sipas vendimeve gjyqësore	35
15. Rekomandimet	38
16. Gjetjet e IKD lidhur me trajtimin e rasteve dhe kohëzgjatjen e gjykimeve.....	40
Annex 1. Analizë e gjykimit të Krimeve të Rënda nga Gjykatat e vendit.....	42
ANEX 2. Rastet DP	55
ANEX 3. Rastet civile.....	63

Lista e shkurtesave

GjEDNj	Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
GjK	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
DP	Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal
DC	Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
DKR	Departamenti për Krime të Rënda
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
GjTh	Gjykata Themelore
GjA	Gjykata e Apelit

1. Përmbledhja ekzekutive

Republika e Kosovës akoma nuk ka arritur të ndërtojë një sistem gjyqësor efikas i cili do ti garantonte secilit individ dhënien e drejtësisë në kohë të arsyeshme. Kjo për shkak se proceset gjyqësore në Kosovës nuk procedohen brenda afateve ligjore, ashtu që çështje të ndryshme që shtrohen para gjykatës për vendosje duhet të presin me vite të tëra deri në epilogun final. Një konstatim të tillë e ka dhënë edhe Komisioni Evropian në Raportin e Progresit për vitin 2021, ku e përshkruan drejtësinë kosovare si “të ngadalshme e jo efikase”.

IKD në kuadër të këtij punimi analitik ka analizuar disa nga shkaqet që ndikojnë në cenimin e së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në Republikën e Kosovës. Sipas këtij hulumtimi rezulton se një nga arsyet që pengon procedimin efikas me lëndë është mbingarkesa me lëndë e sistemit gjyqësor. Në fund të qershorit 2021 rezultojnë të jenë 200,497 lëndë në pritje për tu zgjidhur nga gjyqësori. Krahas kësaj, efikasiteti i gjyqësorit në zgjidhjen e lëndëve në punë ka shënuar një trend negativ. Në vitin 2018 janë zgjidhur 42.33% të lëndëve, në vitin 2019 janë zgjidhur 39.81%, për vitin 2020 vetëm 29.10%, ndërsa për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 kemi një rënie të theksuar të efikasitetit në vetëm 20.18%, ku sipas këtyre të dhënave del se për çdo vit ka pasur rënie kritike të numrit të lëndëve të zgjidhura nga gjykatat. Ndonëse ka pasur rritje të numrit të gjykatësve nga 352 sa ishin në vitin 2018, në 388 gjykatës në vitin 2019, pastaj në 391 gjykatës në vitin 2020 dhe për Janar-Qershor në 379 gjykatës, kjo nuk ka reflektuar edhe në rritjen e efikasitetit në kryerjen e lëndëve në punë, derisa numri i lëndëve në pritje është tepër i lartë.

Gjatë analizës lidhur me përmbushjen e normës orientuese vjetore nga gjykatësit sipas rregullores së përcaktuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka rezultuar se gjykatësit që kanë gjykuar lëndë penale të përgjithshme e kanë tejkaluar këtë normë vetëm në vitin 2018, ndërsa nuk e kanë përmbushur atë në vitin 2019 dhe 2020. Ndërkaq, gjykatësit e krimeve të rënda e kanë përmbushur normën e tyre orientuese vjetore për këtë periudhë, derisa gjykatësit civilist nuk e kanë përmbushur fare këtë normë orientuese gjatë kësaj periudhe raportuese.

Nga statistikat e prezantuara nga KGjK rezulton se sistemi gjyqësor “vuan” nga lëndët e vjetra që nuk janë proceduar brenda afateve të arsyeshme e janë në pritje për tu zgjidhur. IKD ka evidentuar se gjatë periudhës Janar-Qershor 2021 gjykatat kanë qenë të ngarkuara me 14,429 lëndë të vjetra DP që përbëjnë **34.25%** të totalit të këtyre lëndëve, pastaj me **2,164** lëndë të vjetra DKR apo **41.67%** të totalit të lëndëve në punë dhe **25,764** lëndë “të vjetra” civile, që përbëjnë **23.06%** të totalit të lëndëve në punë gjatë kësaj periudhe.

Ndër faktorët që i kontribuon zvarritjes së procedurave gjyqësore është edhe ping-pongu me lëndët gjyqësore ndërmjet gjykatave të shkallës së parë dhe asaj të dytë. Sipas statistikave rezulton se Apeli në vitin 2018 ka kthyer në rigjykim 26.57% të lëndëve civile, për vitin 2019 ka kthyer 28.09% të lëndëve, derisa nuk ka pasur të gjeneruara statistika të tilla për vitin 2020. Sa i përket lëndëve DP, Apeli në vitin 2018 ka kthyer 12.95% të lëndëve në rigjykim, për vitin 2019, 19.25% të lëndëve, derisa për vitin 2020, 20.43% të lëndëve janë kthyer në rigjykim. Sa i përket lëndëve DKR rezulton se Apeli për vitin 2018 ka kthyer në rigjykim 17.37% të lëndëve

të zgjidhura, për vitin 2019, 22.54% dhe për vitin 2020, 20.11% të lëndëve janë kthyer në rigjykim.

IKD ka analizuar edhe çështjen e shtyrjes së seancave gjyqësore si faktor që ndikon në kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, të dhëna këto që gjenerohen nga monitorimi sistematik i sistemit të drejtësisë. Në vitin 2019 në DP e GjTh-ve janë shtyrë 30.80% e seancave, në vitin 2020, janë shtyrë 33.25%, ndërsa për periudhën kohore 1 janar – 30 nëntor 2021, janë shtyrë 810 seanca DP apo 37.90% e tyre. Në divizionin civil për vitin 2019, janë shtyrë 22.07% e seancave, në vitin 2020 janë shtyrë 23.52%. Për periudhën janar-nëntor 2021, janë shtyrë 22.25%. Sa i përket krimeve të rënda, në vitin 2019 janë shtyrë 24.63% e seancave DKR, për vitin 2020 janë shtyrë 31.26%, derisa për periudhën janar-nëntor 2021 janë shtyrë 26.24% e seancave DKR.

IKD për të analizuar kohëzgjatjet e procedurave gjyqësore në shkallë të parë dhe të dytë në çështjet DP, DKR dhe DC ka analizuar gjithsej 250 aktgjykime të përzgjedhura në mënyrë rastësore. Nga aktgjykimet e analizuara në DP, rezulton se nga ngritja e aktakuzës e deri në vendimin e shkallës së parë kanë kaluar 2,309 ditë apo më shumë se 6 vite. Tek lëndët DKR, kohëzgjatja e gjykimit në shkallë të parë nga ngritja e aktakuzës është 2,158 ditë apo afër 6 vite. Në çështjet civile nga ushtrimi i padisë e deri tek vendimi i shkallës së parë procesi ka zgjatur 1755 ditë, ndërsa deri në marrjen e vendimit të formës së prerë janë dashur 1,282 ditë apo 3.5 vite. Ndërsa, kohëzgjatja nga vendimi i shkallës së parë tek lëndët DP e deri në formën e prerë është 497 ditë apo 1.4 vite, derisa tek rastet DKR procedura deri në vendimin e shkallës së dytë ka zgjatur 252 ditë apo 0.68 vite.

Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore mund të trajtohet edhe nga mungesa e një mjeti efektiv juridik i cili do tu ofronte qytetarëve tanë mbrojtjen efektive të së drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme. Në këtë drejtim qytetarët tanë janë të pambrojtur, pasi Republika e Kosovës nuk ka paraparë asnjë mjet i cili do të përdorej nga ta qoftë për të përshpejtuar procesin dhe për të realizuar dëmshpërbim për pasojat e shkaktuara në mos realizimin me kohë të kësaj të drejte.

Gjatë periudhës kohore 2019-tetor 2021, Gjykata Kushtetuese ka pranuar gjithsej shtatë (7) kërkesa nga të cilat pesë u referohen çështjeve civile, një çështjeve penale dhe një administrative, lidhur me pretendimet për cenim të kësaj të drejte. Në të këto kërkesa Gjykata Kushtetuese ka vendosur se nuk janë plotësuar kushtet për të gjetur shkelje të së drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme.

Edhe ankesat e parashtruara nga qytetarët tek Avokati i Popullit lidhur me pretendimet për zvarritje të procedurave gjyqësore e cenim të kësaj të drejte janë të shumta. Në vitin 2017 ishin 261 ankesa të tilla, në vitin 2018 kanë qenë 316, në vitin 2019 ishin 316 sosh dhe në vitin 2020 vetëm 213.

2. Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm kohor sipas standardeve të GjEDNj

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj) si një ndër dokumentet më të rëndësishme në sferën e të drejtave dhe lirive të njeriut, i kushton një rëndësi të veçantë realizimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm.

Zhvillimi i procesit gjyqësor brenda një kohëzgjatje të arsyeshme është një koncept juridik themelor, i sanksionuar në nenin 6.1 të KEDNj. Lidhur me këtë Konventa ka përcaktuar se: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një kohëzgjatje të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”*.

Gjykimin në kohë të arsyeshme e shpjegon më së miri parimi i mirënjohur në drejtësi se *“drejtësia e vonuar, është drejtësi e mohuar”*.

Ky parim u vë detyrimin bartësve të sistemit të drejtësisë që me efikasitetet të udhëheqin dhe të përfundojnë trajtimin e rasteve gjyqësore, i cili efikasitet duhet të konsistojë të paktën në respektimin e afateve ligjore. Një proces i rregullt gjyqësor sendërtohet mbi premisat e një drejtësie të mirë administruar, e cila pikë së pari i garanton secilit individ mbrojtje efektive të të drejtave të tyre, dhe së dyti, përcjell idenë se çdo person i nënshtrohet të njëjtave rregullave, për tu konsumuar koncepti ideal i barazisë para ligjit, ku dhënia e vendimit final bazohet në provat e mirë administruara dhe të shqyrtuara nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, dhe ku çdo personit, i garantohet e drejta që të ushtrojë mjete juridike ndaj këtyre vendimeve gjyqësore.

Kjo e drejtë, e cila është shumë e rëndësishme për të siguruar një gjykim të drejtë, duhet balancuar edhe me interesa tjera të rëndësishme, si siguria që vendimet të jenë të sakta, e që palëve tu jepet kohë e mjaftueshme për të përgatitur çështjen.

GjEDNj ka elaboruar në jurisprudencën e saj kriteret objektive për të analizuar rast pas rasti nëse një çështje është shqyrtuar apo jo në përputhje me standardin e afatit të arsyeshëm. Këto kriteret janë: *Kompleksiteti faktik dhe juridik i çështjes, sjellja e organit procedues si dhe e personave të tjerë publik që kanë detyrime kushtetuese dhe ligjore për administrimin e drejtësisë, sjellja e palëve dhe rëndësia e që ka çështja për palët apo rreziku që sjell për to vonesa.*

Shkelja e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm manifestohet në dy forma dhe atë për shkak të zvarritjes së procedurës gjyqësore deri në epilogun final të një rasti të caktuar dhe së dyti, mund të shkelet për shkak të zvarritjes në ekzekutimin e vendimit final, pas nxjerrjes së tij nga gjykatat.

3. Jurisprudenca e GjEDNj në zbatimin e standardit për gjykim brenda afatit të arsyeshëm

Për momentin e fillimit dhe përfundimit të afatit të arsyeshëm për një çështje penale dhe civile ekzistojnë disa qëndrime. Lidhur me këtë, GjEDNJ ka nxjerrë vendime që kanë përcaktuar kritere të përgjithshme për kohën e fillimit dhe përfundimit të afatit të arsyeshëm.

Standardi i Konventës për proceset penale ka paraparë se periudha e vlerësimit të kohëzgjatjes duhet të fillojë ditën kur personi "*akuzohet*" dhe përfundon kur vendimi i formës së prerë të gjykatës është ekzekutuar plotësisht. Varësisht nga specifikat e çështjes e cila është objekt shqyrtimi, periudha e përgjithshme e kohëzgjatjes së proceseve duhet si rregull të përfshijë procesin e ankimit në gjykatat më të larta, duke përfshirë gjithashtu dhe ankimin kushtetues dhe procedurën përmbartimore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Për proceset civile periudha e përgjithshme për vlerësimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore duhet të fillojë nga data e paraqitjes së padisë civile në gjykatë¹ dhe duhet të përfundojë kur vendimi përfundimtar i gjykatës ekzekutohet në mënyrë efektive.

Në çështjen *Mc Farlane kundër Irlandës*, kjo gjykatë thekson që në çështjet penale, nocioni "kohë e arsyeshme" i paraparë sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së, fillon të zbatohet sapo një person "të akuzohet".² Ndërsa në çështjen *T. kundër Britanisë së Madhe*, kjo gjykatë thekson se nocioni "afat i arsyeshëm", mbulon të gjithë procedurat penale, duke përfshirë edhe procedurat e apelit dhe përcaktimin e dënimit.

Në kërkesën që gjykimi i çështjeve të bëhet brenda "një afati të arsyeshëm", GjEDNJ në rastin "*H kundër Francës*" vë theksin tek rëndësia e administrimit të drejtësisë pa vonesa, e kundërta e së cilës mund të kërcënojë efektshmërinë dhe besueshmërinë e saj.³

Vonesat të cilat vijnë si rezultat i grumbullimit afatgjatë të çështjeve të trashëguara si të pakryera në gjykata, kombinuar me mos marrjen e masave për të korrigjuar situata të tilla, në rastin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës* nga GjEDNJ janë konsideruar shkelje të KEDNJ-së.⁴ Të njëjtin qëndrim GjEDNJ e ka shprehur edhe në rastin "*Probstmeier kundër Gjermanisë*", ku ka konstatuar se mbingarkesa kronike e gjykatave nuk mund të justifikojë tejzgjatjen e proceseve.⁵

Gjykata rregullisht vë në pah se neni 6.1 vendos mbi Shtetet Kontraktuese detyrimin për t'i riorganizuar sistemet gjyqësore të tyre në mënyrë të atillë që gjykatat të mund t'i përmbushin

¹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *Scopelliti kundër Italisë*. 23 nëntor 1993, paragrafi 18.

² Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *Mc Farlane k. Irlandës*. nr.31333/06. Aktgjykim. Strasburg. 10 shtator 2010. Par. 143.

³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *H kundër Francës*. Aktgjykim. 24 Tetor 1989. Par.58.

⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*. Aktgjykim. 13 korrik 1983. Par.29.

⁵ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *Probstmeier kundër Gjermanisë*. Aktgjykim. 1 korrik 1997. Par. 64.

secilën prej kërkesave të saj, përfshirë edhe detyrimin për t'i shqyrtuar çështjet gjyqësore brenda një afati kohor të arsyeshëm.⁶

Në çështjen "Topallaj kundër Shqipërisë" dhe "Luli & të tjerët kundër Shqipërisë" GjEDNj u shpreh se gjykatat e brendshme kanë kontribuar për tejzgjatjen e proceseve duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në mënyrë të përsëritur tek gjykatat më të ulëta.⁷

Ndonëse GjEDNj-ja nuk përcakton limite kohore specifike dhe merr në konsideratë rrethanat e çdo çështjeje për të vlerësuar vonesat, një studim i vitit 2006 i kryer nga CEPEJ (Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë) ka treguar se një kohëzgjatje deri në dy vjet e një çështjeje jo komplekse zakonisht konsiderohet nga GjEDNj-ja si e arsyeshme.⁸ Për sa i përket çështjeve komplekse, studimi i përmendur më sipër vuri në dukje se për çështjet që kishin zgjatur më shumë se 8 vjet kishte shkelje, ndërkohë që çështjet që kanë zgjatur më shumë se pesë vjet rrallë kanë marrë miratimin e Gjykatës.⁹

4. Standardi i gjykimit në afat të arsyeshëm dhe kohëzgjatja e gjykimeve sipas rendit juridik kosovar

Në kuadrin e këtyre të drejtave të garantuara në rendin kushtetues kosovar, një vend të rëndësishëm ka zënë edhe e drejta për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, e cila është ranguar në kategorinë e postulateve kushtetuese.

Për të jetësuar në praktikë të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 31 parashikon detyrimin e organeve gjyqësore që të përfundojnë gjykimin e çështjeve në një afat të arsyeshëm. Ky koncept themelor është inkorporuar me nenin 31.2 të Kushtetutës sonë¹⁰ e po ashtu edhe me nenin 7.2 Ligjit nr. 06/L - 054 për gjykatat¹¹. Në paragrafin 5 të po kësaj dispozite përcaktohet obligimi i gjykatave që të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.

Mbi premisa të tilla, Kodi Nr. 04/L-123 i procedurës penale, si një ndër aktet më të rëndësishme në sferën procedurale-penale, në nenin 5.1 të tij, ka përcaktuar se “Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme”. Në kuptim të realizimit të një procesi të rregullt gjyqësor, në nenin 5.2 të këtij kodi parashihet edhe se “Gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të

⁶ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Muti kundër Italisë. Aktgjykim. 23 mars 1994, paragrafi 15.

⁷ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Topallaj kundër Shqipërisë. Aktgjykim. 21 prill 2016. par.77.

⁸ Komisioni Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ) Length of court proceedings in the member states of the Council of Europe based on the case-law of the European Court of Human Rights [Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut], (Strasburg, Këshilli i Evropës, 2007), faqe 16, gjendet në: http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/Delais/Calvez_en.pdf.

⁹ Po aty, fq.6.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 31.2”Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”

¹¹ Ligji nr.06/L-054 për gjykatat. Neni 7.2 “Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor”

zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë”.

Sa i përket kohëzgjatjes së procedurës penale, e cila në vetvete konsiston në kufizim të lirive dhe të të drejtave të njeriut, ligjvënësi ynë ka paraparë dy afate për përfundimin e proceseve gjyqësore, pas konfirmimit të aktit akuzues. Rrjedhimisht, Kodi i procedurës penale, si ligj bazik në këtë fushë, në nenin 314.2 ka përcaktuar afatin 90 ditor të përfundimit të shqyrtimit gjyqësor kur i njëjti zhvillohet para gjyqtarit të vetëm gjykues dhe afatin 120 ditor të përfundimit të shqyrtimit gjyqësor kur i njëjti mbahet para trupit gjykues. Në raste të caktuara, shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet me aktvendim të arsyetuar, sipas kushteve të parapara me paragrafin e dytë të këtij neni.

Në funksion të trajtimit efikas të çështjes penale, ky kod ka paraparë afate strikte për ndërmarrjen e veprimeve procedurale nga palët në procedurë, duke filluar që nga faza hetimore, e pastaj nga momenti i ushtrimit të aktit akuzues në gjykatë e deri në epilogun final të rastit.

Sa i përket afatit për realizimin e procedurës civile vlen të theksohet se legjislacioni ynë nuk ka përcaktuar një afat të caktuar për kohëzgjatjen e trajtimit të një çështje civile, por janë paraparë afate të cilat duhen respektuar nga palët në procedurë që në momentin e ushtrimit të padisë në gjykatë e deri në zgjidhjen përfundimtare të rastit. Megjithatë, Ligji Nr. 03/L-006 procedurën kontestimore, në nenin 10.1 të tij nënvizon obligimin që *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji”*. Vet respektimi i këtyre afateve procedurale të parapara me ligj, presupozon se trajtimi i një çështje civile nga gjykata e shkallës së parë duhet të jetë vetëm çështje muajsh.

Si rrjedhojë, përfundimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ndikon drejtpërdrejt në dhënien fund të shkeljes apo cenimit të një të drejte të njohur me ligj, në një kohë sa më të shkurtër që të jetë e mundur, çka i kursen palës së dëmtuar cenime të mëtejshme dhe detyësore, të cilat për nga natyra e tyre janë jo vetëm materiale, por gjithashtu morale e psikologjike. Po ashtu, çfarëdo vonese në trajtimin e një çështje penale, mund të rëndojë edhe më tepër pozitën e të akuzuarit, ku krahas gjykimit “shoqëror” për veprimin e kryer, i njëjti privohet nga e drejta që të gëzojë në formë të plotë disa të drejta e liri themelore që nga momenti i inicimit të procedurës penale, kur dihet mirëfilli se këtë të fundit e mbron edhe parimi themelor i “prezumimit të pafajësisë”.

5. Gjykata Kushtetuese dhe kërkesat e ushtruara për shkelje të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm

Gjykata Kushtetuese e Kosovës (GjK) është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Në cilësinë e palës së autorizuar mund të paraqiten edhe individët, të cilët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale. Në kuadër të këtyre të drejtave dhe lirive themelore për të cilat qytetarët mund të ngrenë çështje para kësaj gjykate, bën pjesë edhe e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Në aspektin procedural, konform nenit 113.7 të Kushtetutës, individët mund të fillojnë procedurën para kësaj gjykate, vetëm atëherë pasi ti kenë shteruar të gjitha mjetet e disponueshme dhe efektive juridike kundër vendimeve të gjykatave të rregullta. Në këtë kuptim, prezumohet se qytetarët në parim duhet të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre nga gjykatat e rregullta, të cilat kanë për detyrim të sigurojnë një proces të rregullt ligjor të realizuar në një afat të arsyeshëm.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës për periudhën kohore 2019 – tetor 2021 ka pranuar gjithsej shtatë (7) kërkesa lidhur me pretendimet për cenim të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor. Pesë nga këto kërkesa u referohen çështjeve civile, një kërkesë lidhur me çështje administrative dhe një kërkesë lidhur me një çështje penale.¹² Gjatë kësaj periudhe raportuese, Gjykata Kushtetuese ka vendosur se në asnjërën nga këto raste nuk janë plotësuar kushtet për të gjetur shkelje të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Në përgjigjen e dhënë për IKD lidhur me këtë çështje Gjykata Kushtetuese ka udhëzuar palët që të kërkojnë kompensim monetar të dëmit material, në rastet kur vetëm konstatimi i kësaj shkelje kushtetuese të gjykim në afat të arsyeshëm nuk është i mjaftueshëm.

“Andaj, në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese nuk është i mjaftueshëm për të evituar pasojat e shkeljes kushtetuese dhe kur kompensimi monetar është i domosdoshëm, i’u takon palëve të përfshira në rast që të shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi, për realizimin e mëtejshëm të të drejtave të tyre, duke përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar kompensimin e dëmit material, si rezultat e shkeljeve të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, të konstatuara nga Gjykata Kushtetuese”, thuhet në përgjigjen e dhënë nga GjK.

6. Ankesat e qytetarëve tek Avokati i Popullit sa i përket zvarritjes të lëndëve gjyqësore

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) paraqet një kategori të rëndësishme kushtetuese dhe një mekanizëm ligjor i cili mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 135.5 të saj, i ka dhënë Avokatit të Popullit edhe autorizimin që të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.

Ndërkaq, Ligji nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit i jep autorizime këtij institucioni që të aktivizohet në funksion të realizimit të funksionimit sa më të mirë të sistemit gjyqësor, veçmas në rastet kur konstatohet se një proces gjyqësor nuk procedohet sipas afateve të arsyeshme kohore. Në këtë ligj, me nenin 16.8 parashihet që *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave”*. Po ashtu, sipas par.9 të këtij neni, parashihet se avokati i popullit

¹² Përgjigje për IKD nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. 17 nëntor 2021.

mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit.

Ankesat që paraqiten nga qytetarët tek ky institucion sa i përket zvarritjeve të procedurave gjyqësore janë të shumta. Sipas statistikave zyrtare të pranuar nga Avokati i Popullit rezultojnë se ky institucion gjatë vitit 2020 ka pranuar gjithsej 213 ankesa të tilla, pastaj gjatë vitit 2019 ka pranuar 316 ankesa, 317 ankesa në vitin 2018 dhe 261 ankesa në vitin 2017.¹³

Viti	• Ankesa për zvarritje tek IAP
2017	• 261
2018	• 317
2019	• 316
2020	• 213

Tabela 1. Ankesat e qytetarëve tek IAP për zvarritje të procedurave gjyqësore për vitet 2017-2020

Në funksion të realizimit të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor, Institucioni i Avokatit të Popullit kishte përgatitur një raport me rekomandime (ex officio) në lidhje me zgjidhjen efektive të zvarritjeve të procedurave gjyqësore, si shkelje e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë raport, Institucioni i Avokatit të Popullit kishte rekomanduar iniciimin e një nisme legjislativë për propozimin e ligjit për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Si kërkesë specifike në kuadër të këtij rekomandimi ishte përcaktimi i mjeteve efektive juridike për rastet e zvarritjeve të procedurave gjyqësore, në përputhje me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare në sferën e të drejtave dhe lirive të njeriut.¹⁴

Institucioni i Avokatit të Popullit, në raportin vjetor të punës për vitin 2020, sa i përket sistemit gjyqësor thekson se ankesat ndaj gjykatave zënë vendin e dytë me 25% të numrit të përgjithshëm të ankesave. Këto ankesa bazohen në pretendimet për zvarritje të pajustificueshme në vendosjen e rasteve gjyqësore.¹⁵

7. Përgjegjësia e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në procedimin efikas të proceseve gjyqësore

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) është institucion i pavarur i cili ka për detyrë që të sigurojë që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme. Në kuadër të këtyre përgjegjësisë të KGjK-së ndër të tjera hyjnë menaxhimi, administrimi dhe garantimi i funksionimit efikas të gjyqësorit.

¹³ Përgjigje për IKD nga IAP. 18 nëntor 2021.

¹⁴ Institucioni i Avokatit të Popullit. "Raport Ex officio nr. 129/2018 me rekomandime i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në lidhje me zgjidhjen efektive të zvarritjeve të procedurës gjyqësore –shkelja e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm". Prishtinë. 6 mars 2018. Fq. 6.

¹⁵ Institucioni i Avokatit të Popullit. "Raporti Vjetor 2020". Prishtinë. 2021. Fq. 28.

Për këtë qëllim, ky këshill ka miratuar disa plane strategjike ku ndër prioritetet kryesore për tu realizuar është përcaktuar administrimi efikas i drejtësisë, duke reduktuar numrin jashtëzakonisht të madh të lëndëve të vjetra, për të garantuar zgjidhjen e tyre brenda një afati të arsyeshëm.

Këto plane strategjike, duke filluar nga plani i parë i cili vllente për periudhën kohore 2007-2012, pastaj plani i dytë me zbatim për vitet 2014-2019 dhe plani i fundit i cili aktualisht është në fuqi, i cili parashihet të vlejë edhe për vitin 2022, nuk kanë arritur që krijojnë një gjyqësor efektiv ku drejtësia administrohet brenda afateve të arsyeshme.

Ndër të tjera, strategjia e cila është në fuqi për gjyqësorin, si qëllim strategjik të inkorporuar tek pjesa e Administrimit efikas dhe efektiv të drejtësisë ka paraparë *“Përmirësimin e praktikave të menaxhimit të lëndëve për të siguruar që lëndët e reja zgjidhen në afat kohor të arsyeshëm”*. Si objektivi tjetër strategjik, e përfshirë edhe në këtë strategji ishte ulja e numrit të lëndëve në pritje për më shumë se dy vjet. Të gjitha këto planifikime të KGjK-së, të përcaktuara si qëllime strategjike, shpresojmë se nuk do mbesin vetëm politika në letër.

Në funksion të kësaj, parashihej si qëllim strategjik edhe sigurimi i shpërndarjes proporcionale të personelit jo gjyqësor për të ndihmuar në mënyrë efektive gjyqësorin në administrimin e zgjidhjes së lëndëve. Megjithatë, siç ka deklaruar vet kryesuesi i KGjK-së Albert Zogaj në mbledhjen e këtij institucioni, është konstatuar mos përfillja e kësaj objektivit strategjik, pasi ishte hasur shpërndarje jo proporcionale dhe preferenciale të stafit mbështetës.¹⁶

KGjK kishte miratuar edhe një strategji të veçantë për të adresuar problematikën e numrit të madh të lëndëve të vjetra që e ngarkojnë sistemin gjyqësor të Kosovës. Më saktë, në gusht të vitit 2013, ky këshill kishte miratuar Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra e cila ishte inkorporuar edhe në Planin Strategjik të Gjyqësorit të Kosovës 2014-2019. Kjo nismë e Këshillit, edhe pse kishte paraparë një sërë qëllimesh strategjike e një plan zbatimi, nuk ka arritur që të jetësohet në praktikë dhe të realizojë një ndër objektivat kryesore të saj, administrimin efikas dhe efektiv të drejtësisë.

Aktualisht, KGjK ka ndërmarrë një iniciativë të re për të adresuar këtë problematikë serioze. Në mbledhjen e mbajtur nga ky këshill më 1 nëntor 2021, është marrë vendimi për të draftuar një Strategji të re për zvogëlimin e lëndëve të vjetra.¹⁷

Në një përgjigje të dhënë për IKD lidhur me këto çështje, kryesuesi i KGjK Albert Zogaj ka rikonfirmuar të dhënë tanimë të njohur se ka vonesa në trajtim të lëndëve, por që sipas tij, këshilli është duke u përpjekur që të shkurtohet koha e pritjes së lëndëve.¹⁸ Kryesuesi Zogaj ka listuar disa nga arsyet që kanë sjell deri tek numri i madh i lëndëve që nuk procedohen brenda afateve të arsyeshme kohore. Sipas Zogajt, ndër arsyet kryesore janë numri i vogël i gjyqtarëve

¹⁶ “Kryesuesi i KGjK-së thotë se në gjykata të caktuara ka pasur shpërndarje jo proporcionale dhe preferenciale të stafit, por se kjo nuk do të lejohet më”, Betimi për Drejtësi, 18 tetor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryesuesi-i-kgjk-se-thote-se-ne-gjykata-te-caktuara-ka-pasur-shperndarje-jo-proporcionale-dhe-preferenciale-te-stafit-por-se-kjo-nuk-do-te-lejohet-me/>).

¹⁷ Vendimi i KGjK nr.318/2021. 01.11.2021.

¹⁸ Përgjigje për IKD nga Kryesuesi i KGjK Albert Zogaj. 19 nëntor 2021.

dhe stafit, pastaj numri i madh i lëndëve në punë nëpër gjykata, ndryshimet e shpeshta ligjore, dështimi në dërgimin e ftesave, çështjet tjera logjistike si mungesa e hapësirave dhe gjendja jo e mirë e objekteve.

8. Mungesa e mjetit efektiv juridik në legjislacionin vendor kundër zvarritjes së gjykimeve

Çështja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore mund të trajtohet edhe nga aspekti i mungesës së mjeteve juridike efektive për t'u mbrojtur nga zvarritja e këtyre gjykimeve. Garancia për mjete efektive, është e mishëruar në sistemin tonë juridik, përmes së cilit, kërkohet nga shteti që tu sigurojë qytetarëve mjete juridike të cilat në teori dhe praktikë janë efektive kundrejt shkeljeve të të drejtave të garantuara në Konventë. Lidhur me këtë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 54 të saj ka paraparë mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.¹⁹

Krahas kushtetutës, edhe KEDNJ në nenin 13 të saj kërkon nga autoritetet vendore që të garantojnë mbrojtje efektive të të drejtave që rrjedhin nga Konventa, duke ofruar zgjidhje efektive juridike para një organi vendas.

Mirëpo, këto detyrime që rrjedhin nga neni 54 i kushtetutës dhe neni 13 i Konventës, dokument ky që ka epërsi ndaj ligjeve tona, akoma nuk janë përmbushur në praktikë nga Republika e Kosovës, pasi që kjo e fundit akoma nuk ka krijuar bazë ligjore ku do të parashihej mjeti juridik kundër cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Nevojën për inkorporimin e këtyre mjeteve në legjislacionet vendore e ka konstatuar GjEDNJ në rastin Kudla kundër Polonisë. Në këtë vendim, GjEDNJ ka vërtetuar ekzistimin e një lidhjeje sistematike të së drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm (Neni 6.1 i KEDNJ) dhe të drejtës për mjet juridik efektiv nga neni 13 i kësaj konvente. Aty theksohet se mjetet në lidhje me tejzgjatjen e proceseve gjyqësore janë "efektive" vetëm nëse mbulojnë të gjitha fazat e proceseve, ofrojnë dëmshpërblim të shpejtë, dhe përshpejtojnë kohëzgjatjen e procedurave në tërësi.²⁰ Neni 13 i Konventës, e cila ka zbatim të drejtpërdrejtë në legjislacionin tonë parasheh se mjeti efektiv i ankimit duhet të jetë i tillë që jo vetëm të vendosë lidhur me të drejtat që parashikon KEDNJ, por edhe të rivendosë sa të jetë e mundur të drejtën e shkelur.²¹

Në pajtim me parimin e subsidiaritetit, çështja e zgjatjes së tepërt të procedurave duhet të trajtohet fillimisht nga gjykatat vendore. Lidhur me këtë, në sistemin juridik të Kosovës, as Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk ka tagër ligjor të shqiptoj kompensim të drejtë ndaj parashtruesve të kërkesës atëherë kur konstaton shkeljen e të drejtës në gjykimin brenda afatit të arsyeshëm kohor. Në mungesë të një kompetence të tillë për caktimin e shpërblimit, GjK vetëm i udhëzon palët që të paraqesin padi për kompensim dëmi përsëri në gjykatat e rregullta.²²

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 54 "Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".

²⁰ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Kudla k. Polonisë. Aktgjykim. 26.10.2000. par.160

²¹ Vendim për çështjen Scordino kundër Italisë i datës 29 mars 2006 i Gj.E.D.Nj.

²² B.M. Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim për papranueshmëri. 30 shtator 2019. Par.197.

Në këtë kontekst, qytetarët tanë të cilët potencialisht mund të jenë viktimë e stërzgjatjes së procedurave gjyqësore nuk posedojnë ndonjë mjet efektiv juridik për të rivendosur të drejtën e tyre për arsye se vendimet e GJKK-së në konstatimin e shkeljes së nenit 6.1 kanë më tepër natyrë deklarative sesa rikuperuese. Për më tepër, udhëzimi në procedurë civile mbart me vete rrezikun e mos procedimit me kohë të kërkesës për kompensim, çka do të paraqiste një barrë joproporcionale për të dëmtuarin.

Në këtë drejtim, një hap pozitiv është iniciativa e Ministrisë së Drejtësisë për themelimin e një grupi punues për fillimin e hartimit të draftit të Koncept dokumentit për realizimin e të drejtave civile, përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Megjithatë, është e domosdoshme që një nismë e tillë të jetë gjithëpërfshirëse në kuptim të realizimit të të drejtave procedurale, e jo të kufizohet vetëm në realizimin e të drejtave civile në kuptim të së drejtës për gjykim të drejtë të realizuar brenda afatit të arsyeshëm.

9. Roli i CEPEJ-it për të përmirësuar menaxhimin efikas të proceseve gjyqësore

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka krijuar Komisionin Evropian për Efikasitetin në Drejtësi (CEPEJ) në Shtator 2002, me synimin që të ofrojë rekomandime konkrete për metodologjinë që shtetet duhet të përdorin për të identifikuar dhe korrigjuar defektet që janë prezente në sistemet juridike kombëtare, me qëllim të menaxhimit efektiv të gjykimeve.

Për të realizuar një aktivitet të tillë, ky komision ka ndërmarrë iniciativa të rëndësishme, duke krijuar Rrjetin e Gjykatave Pilot për monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave dhe ka hartuar një list të treguesve që u shërbejnë vendeve për të analizuar kohëzgjatjet e gjykimeve.

Programi Kuadër i adoptuar nga CEPEJ ka përcaktuar standarde për trajtimin e çështjeve gjyqësore brenda një periudhe të përshtatshme duke theksuar rëndësinë e parashikimit të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor. Gjithashtu, ai vë në dukje ndikimin e ndjeshëm që kanë periudhat pasive (koha në pritje) në kohëzgjatjen e këtij procesi.

Ky komision për të rritur efikasitetin në dhënien e drejtësisë ka dhënë një sërë rekomandimesh të cilat mund ti përmbledhim si vijon: Përcaktimin të afateve brenda të cilave duhet të përfundojë procesi, duke parashikuar një kohëzgjatje të përafërt të secilës fazë të veçantë të përfshirë në proces, Optimizimi i proceseve gjyqësore duke shmangur vonesat e panevojshme dhe zvarritjet e paarsyeshme, Intensifikimin e bashkëpunimit midis organit që kryen procedurën dhe akterëve të tjerë të përfshirë në dhënien e drejtësisë (palët, avokatët, ekspertët, dëshmitarët etj.), duke krijuar sinergjinë e nevojshme për të rritur produktivitetin në çdo fazë të procesit.

Ndërkaq, lista e treguesve e hartuar nga ky komision përfshinë: aftësinë për të llogaritur kohëzgjatjen e procesit në tërësi, pastaj vendosjen e standardeve për kohëzgjatjen e procesit, aftësia për të monitoruar rrjedhën e procesit, identifikimi i menjëhershëm i vonesave

dhe reduktimi i pasojave të tyre dhe treguesi i gjashtë ka të bëjë me përdorimin e teknologjisë moderne si mjet për menaxhimin e kohës në sistemin e drejtësisë.²³

10. Ngarkesa me lëndë e gjyqësorit si faktor që ndikon në zvarritjen e procedurave gjyqësore

Kritika se administrimi i drejtësisë në Republikën e Kosovës nuk bëhet me efikasitet, por se vazhdon të jetë i ngadalshëm e jo efikas ka dhënë edhe Raporti i Progresit për vitin 2021 i Komisionit Evropian, teksa ka përshkruar Kosovën se është ende në fazë të hershme për të zhvilluar një gjyqësor që funksionon mirë.²⁴

Një nga problemet më serioze me të cilat vazhdon të përballë sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës vazhdon të mbetet akoma numri i madh i lëndëve të pazgjydhura, e të cilat kanë ndikuar që të mos ketë administrim efikas të drejtësisë. Një rrethanë e tillë ka për pasojë që një numër i madh i çështjeve që prezantohen para gjykatave të mos procedohen me kohë sipas afateve të përcaktuara, për shkak të mbingarkesës së gjykatave me lëndë.

Në bazë të raporteve statistikore të gjykatave që KGJK-ja publikon për çdo vit kalendarik rezultojnë se gjykatat e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018 kanë pasur në punë 425,914 lëndë, prej të cilave kanë zgjidhur 180,290 ose 42.33%, ndërsa numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjydhura është 245,515 ose 57.65%. 109 lëndë janë bartur në kompetencë. Të pranuar në punë gjatë kësaj periudhe kanë qenë gjithsej 118,401.²⁵ Për vitin 2019, sipas këtyre statistikave të KGJK-së, del se gjyqësori ka pasur në punë gjithsej 360,806 lëndë në total, nga të cilat janë zgjidhur 143,650 ose 39.81%, ndërsa të pazgjydhura kanë mbetur 216,899 ose 60.11%. 257 lëndë janë bartur në kompetencë. Të pranuar në punë kanë qenë 115,359 lëndë.²⁶

Vitin 2020 gjykatat e kanë nisur me gjithsej 143,728²⁷ lëndë të cilat ishin trashëguar si të pazgjydhura nga viti paraprak, ndërsa kishin pranuar në punë 104,574 lëndë të reja. Si rrjedhojë, gjykatat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë pasur në punë një total prej 248,302 lëndëve. Gjatë kësaj periudhe raportuese gjykatat kishin zgjidhur gjithsej 72,250 lëndë apo 29.10%, ndërsa të pazgjydhura në fund të këtij viti kishin ngelur gjithsej 176,052 apo 70.90 lëndë.²⁸

Ndërsa, vitin 2021 gjykatat e vendit e kishin nisur me 174,019 lëndë të pazgjydhura që ishin bartur nga viti paraprak, ndërsa gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2021 gjykatat kanë pranuar 77,195 lëndë të reja, ashtu që në punë gjatë kësaj periudhe raportuese kanë pasur 251,214 lëndë.

²³ “Manual i mjeteteve të CEPEJ-Forcimi i efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë”. Këshilli i Evropës. Shtator 2017. (Shih linkun <https://rm.coe.int/manual-i-mjeteve-te-cepej/168076fee1>). Fq.6-10.

²⁴ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian. 2021. Strasburg. Fq. 16. 19.10.2021 (Shih linkun [http://ammk-rks.net/repository/docs/Kosovo-Report-2021-v2_\(1\).pdf](http://ammk-rks.net/repository/docs/Kosovo-Report-2021-v2_(1).pdf)).

²⁵ “Raporti statistikor i gjykatave për vitin 2018”. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Fq.3. (Shih linkun https://www.gjyqesorirks.org/wpcontent/uploads/reports/Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2018_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf).

²⁶ “Raporti statistikor i gjykatave për vitin 2019”. KGJK. Fq.3 (Shih linkun https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/37650_Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2019_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf).

²⁷ Shënim: Mos përputhjet eventuale të të dhënave janë mos përputhje që derivojnë nga raportet statistikore të KGJK.

²⁸ “Raporti statistikor i gjykatave për vitin 2020”. KGJK. Fq.3. (Shih linkun https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/23323_KGJK_Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2020_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf).

Gjatë këtij gjashtë mujori gjykatat e vendit kanë zgjidhur gjithsej 50,717 apo 20.18% të lëndëve në punë, ndërsa në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pazgjidhura 200,497 lëndë apo 79.82%.²⁹

Sipas këtyre statistikave, efikasiteti në zgjidhjen e lëndëve në punë nga gjykatat e vendit gjatë vitit 2018 ka qenë 42.33%, për vitin 2019 ka qenë 39.81%, për vitin 2020 ka qenë vetëm 29.10%, ndërsa për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 kemi një rënie të theksuar të efikasitetit në vetëm 20.18%, ku sipas këtyre të dhënave del se për çdo vit ka pasur rënie kritike të numrit të lëndëve të zgjidhura nga gjykatat.

Ndonëse ka pasur rritje të numrit të gjykatësve nga 352 sa ishin në vitin 2018, në 388 gjykatës në vitin 2019, pastaj në 391 gjykatës në vitin 2020 dhe për Janar-Qershor 2021 në 379 gjykatës, kjo nuk ka reflektuar edhe në rritjen e efikasitetit në kryerjen e lëndëve në punë, derisa numri i lëndëve në pritje është tepër i lartë.

Trendi i lëndëve të pazgjidhura nga viti 2018 e deri në vitin 2020 ka shënuar një rënie prej 28.29%, mirëpo gjatë kësaj periudhe ka rënë edhe numri i lëndëve të reja të pranuar në punë për 11.67%.

Sa i përket vitit 2020 duhet përmendur faktin se si pasojë e pandemisë Covid/19 ka pasur një pezullim të përkohshëm të punës së gjykatave. Pezullimi i punës së gjykatave ka ndodhur nga 16 mars 2020 deri më 1 qershor 2020. Në këtë periudhë kohore nuk janë mbajtur gjykimet përveç rasteve urgjente (dhuna në familje, masat e sigurimit të pandehurit në procedurë penale).

11. Ngarkesa dhe efikasiteti i gjykatave themelore me lëndë për periudhën 2018-Qershor 2021

Sipas statistikave, në vitin 2018 gjykatat themelore dhe degët kanë zgjidhur 163,996 lëndë apo 43.71% nga totali i lëndëve në punë prej 375,151, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 211,046 apo 56.26% e lëndëve. 109 lëndë janë bartur në kompetencë. Në vitin 2019 gjykatat themelore kanë pasur në punë 307,387 lëndë, ndërsa kanë zgjidhur 122,978 apo 40% të lëndëve në punë, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 184,152 lëndë apo 59.90%. 257 lëndë janë bartur në kompetencë.

Gjatë vitit 2020 këto gjykata kanë zgjidhur 52,792 lëndë apo 26.57% të lëndëve në punë, derisa të pazgjidhura në fund kanë mbetur 145,914 apo 73.43% e tyre, e në punë kanë pasur gjithsej 198,706 lëndë.³⁰ Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021, gjykatat e shkallës së parë kanë zgjidhur 40,435 apo 19.09%, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 171,403 apo 80.91%. Në punë kanë pasur gjithsej 211,838 lëndë.

²⁹ “Raporti statistikor i gjykatave për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021”. KGjK. Fq.3. (Shih linkun https://www.gjyqesorirks.org/wpcontent/uploads/reports/79678_SKGJK_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Gjashtemuji_pare_2021.pdf).

³⁰ Shënim: Në statistikën zyrtare të KGjK nuk ka përputhje ndërmjet numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2019 ku figurojnë 184,152 lëndëve, dhe lëndëve që janë bartur si të pazgjidhura në fillim të vitit 2020, që sipas raporteve zyrtare janë 110,981 lëndë, dhe nuk paraqitet asnjë shpjegim se si janë proceduar 73,171 lëndë.

Në vitin 2018 këto gjykata kanë zgjidhur 62,262 lëndë më shumë sesa të pranuar, në vitin 2019, 26,569 lëndë më shumë se sa të pranuar, në vitin 2020 janë zgjidhur 34,933 lëndë më pak, e për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 janë zgjidhur 25,951

Efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve në punë për vitin 2018 është 43.71%, për vitin 2019 është 40%, për vitin 2020 është 26.57%, për periudhën Janar-Qershor është 19.09%, çka dëshmon se vit pas viti ka pasur rënie të theksuar të efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve në punë. Ndonëse ka pasur rënie të efikasitetit, numri i gjykatësve të angazhuar në gjykata themelore ka pësuar rritje, ku në vitin 2018 rezultojnë 282 gjykatës që kanë gjykuar lëndë në shkallë të parë, në vitin 2019 dhe 2020 kemi 311 gjyqtarë, ndërsa për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 figurojnë 304 gjyqtarë.

Nëse analizojmë trendin e lëndëve të pazgjidhura për periudhën 2018-2020 del se kemi rënie prej prej 30.86 të numrit të lëndëve të pazgjidhura që barten vit pas viti. Ngjashëm, kur krahasojmë numrin e lëndëve të pranuar në punë për këtë periudhë raportuese (2018-2020) del se kemi rënie prej 13.77% të këtyre lëndëve.

11.1 Ngarkesa dhe efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve DP për periudhën 2018 – qershor 2021

Sipas statistikave rezulton se gjatë vitit 2018, DP-të e GjTh-ve kanë zgjidhur 24,278 apo 37.68% të lëndëve në punë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 40,118 lëndë apo 62.27%. 20 lëndë janë bartur në kompetencë.³¹ Për vitin 2019, DP-të e GjTh-ve kanë pasur në punë gjithsej 60,461 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 27,192 apo 44.97% të lëndëve në punë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 33,257 lëndë apo 55%. 12 lëndë janë bartur në kompetencë.³²

Ndërsa, gjatë vitit 2020, DP e GjTh-ve kanë pasur në punë 49,674 lëndë të tilla. Nga ky total i lëndëve, gjykatat kishin arrit të zgjidhin 16,281 apo 32.78% të lëndëve në punë, derisa kishin mbetur të pazgjidhura 33,393 lëndë DP apo 67.22%.³³

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2021, DP e GjTh-ve kanë pasur në punë gjithsej 42,121 lëndë, kanë zgjidhur 8,762 apo 20.80% të lëndëve në punë, derisa të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kishin mbetur të pazgjidhura gjithsej 33,359 lëndë të tilla apo 79.20%.

³¹ “Raporti vjetor Statistikor i Gjykatave për vitin 2018”. (Shih linkun https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2018_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf).

³² Thaqi, M. Hoxha A. Halili, E. “Krimet e përgjithshme në Kosovë 2019”. Prishtinë. Nëntor 2020. Fq. 15.

³³ Shënim: Mos përputhjet eventuale të të dhënave janë mos përputhje që derivojnë nga raportet statistikore të KGJK.

Lëndët (DP)	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
2018	42,116	22,300	64,416	24,278	40,118
2019	40,118	20,343	60,461	27,192	33,257
2020	34,492	15,182	49,674	16,281	33,393
1 Janar-30 Qershor 2021	33,175	8,946	42,121	8,762	33,359

Tabela 2. Ngarkesa dhe efikasiteti i gjykatave me lëndë të DP-ve për periudhën 2018 – Qershor 2021

Efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve DP në vitin 2018 DP ishte 37.68%, në vitin 2019 ishte 44.97%, për vitin 2020 ishte 32.78%, ndërsa për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 ishte vetëm 20.80%. Viti 2019 ka qenë viti më efikas dhe ky efikasitet mund të arsyetohet me faktin se ka pasur rritje të gjyqtarëve në DP e GjTh-ve nga 81 sa ishin në vitin 2018 në gjithsej 98 gjyqtarë që kanë zgjidhur lëndë DP gjatë 2019.

Për vitin 2018, gjyqtarët e DP e kishin tejkaluar normën orientuese të përcaktuar nga KGJK-ja duke kryer 7.72 lëndë më shumë, për vitin 2019 ndonëse ka pasur rritje prej 17 gjyqtarëve në këtë divizion, gjykatësit e DP-ve nuk kanë arritur të përmbushin këtë normë, ashtu që mesatarisht një gjykatës ka kryer 277.4 lëndë, që i bie 14.6 lëndë më pak sesa norma vjetore e përcaktuar. Për vitin 2020, të angazhuar kanë qenë 92 gjykatës në DP e GjTh-ve, të cilët mesatarisht kanë kryer 176.9 lëndë, apo 115.1 lëndë më pak sesa norma vjetore e përcaktuar.³⁴

Referuar raporteve statistikore rezulton se gjatë periudhës Janar-Qershor 2021 gjykatat kanë pasur në punë **14,429 lëndë të vjetra DP**, apo shprehur në përqindje i bie se lëndët e tilla përbëjnë **34.25%** të totalit të lëndëve DP që gjykatat kanë pasur në punë gjatë kësaj periudhe.³⁵

11.2 Trendi i zgjidhjes së lëndëve nga DP e GjTh-ve

Nëse analizojmë trendin e zgjidhjes së lëndëve në raport me lëndët e reja të pranuar në punë, rezulton se gjatë vitit 2018 DP e GjTh-ve kanë zgjidhur 1,978 lëndë më shumë sesa të pranuar në punë. Për vitin 2019 janë zgjidhur 6,849 lëndë DP më shumë se sa të pranuar. Në vitin 2020 DP e GjTh-ve kanë arritur të zgjidhin 1,099 lëndë më shumë sesa të pranuar, pasi edhe pse ka rënë numri i lëndëve të pranuar në krahasim me vitin paraprak, ka rënë edhe numri i lëndëve të zgjidhura në krahasim me vitin 2019. Ndërsa në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021, janë zgjidhur 184 lëndë më pak se sa që janë pranuar në punë.

³⁴ Bazuar në rregulloren e 14 shtatorit 2011 për caktimin e normës orientuese të punës së gjyqtarëve, të miratuar nga KGJK, norma orientuese mujore e një gjyqtari në Departamentin e Përgjithshëm është 24 lëndë, ndërsa ajo vjetore 292 lëndë.

³⁵ Shënim: Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra i ka përkufizuar lëndët e tilla si lëndë të cilat janë parashtruar para vitit 2012. Në këtë strategji theksohet se “*Këshilli do të shqyrtojë idenë e përkufizimit të lëndëve të vjetra si lëndë të cilat janë më të vjetra sesa dy vite*”.

Sipas këtyre statistikave del se gjatë periudhës 2018-2020 kemi një rënie të trendit të lëndëve të pazgjidhura në 16.76% dhe kemi edhe rënie prej 31.91% të lëndëve të reja të pranuar gjatë kësaj periudhe raportuese.


Gjatë vitit 2020, gjykata më e ngarkuar me lëndë penale të përgjithshme ishte GjTh në Prishtinë me gjithsej 16,612 lëndë në punë, ndërsa më pak e ngarkuar ka qenë GjTh në Gjakovë me 3,697 lëndë që gjykohen në DP e GjTh-ve. Situatë identike paraqitet edhe në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021, ku GjTh në Prishtinë ka pasur gjithsej 15,654 lëndë në punë, ndërsa më së paku lëndë në punë gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur sërish GjTh në Gjakovë me 2,822 lëndë të tilla.³⁶

DP	2020					Janar-Qershor 2021				
	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
GjTh Prishtinë	13500	4112	17612	4843	12769	12687	2967	15654	2380	13274
GjTh Mitrovicë	3868	2194	6062	2447	3615	3546	1221	4767	1119	3648
GjTh Gjilan	3807	2125	5932	1723	4209	4192	969	5161	1229	3932
GjTh Prizren	4075	1969	6044	2055	3989	3975	1177	5152	1316	3836
GjTh Gjakovë	2460	1237	3697	1590	2107	2099	723	2822	776	2046
GjTh Pejë	2286	1933	4219	1638	2581	2560	910	3470	797	2673
Ferizaj	4496	1612	6108	1985	4123	4116	979	5095	1145	3950

Tabela 3. Ngarkesa e gjykatave me lëndë DP për vitin 2020 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2021


³⁶ Shënim: Të dhënat lidhur me ngarkesën në punë përfshijnë edhe statistikat për ngarkesën me lëndë të degëve të gjykatave themelore.

Sipas statistikave për periudhën Janar-Qershor del se GjTh në Prishtinë ka në punë më së shumti lëndë “të vjetra” me gjithsej 6,507 lëndë, ndërsa më së paku lëndë të tilla ka GjTh në Pejë me 696.



Grafika 1. Ngarkesa me “lëndë të vjetra” DP e GjTh-ve dhe degëve për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021

Sa i përket ngarkesës individuale të gjyqtarëve me lëndë DP gjatë periudhës Janar-Qershor 2021, bazuar në numrin e lëndëve në punë, del se gjykatësit e GjTh në Prishtinë (dhe degët e saj) kanë qenë më të ngarkuarit në punë gjatë kësaj periudhe, duke pasur në punë mesatarisht **782.7** lëndë penale të përgjithshme, ndërsa më pak të ngarkuar me lëndë DP rezultojnë të jenë gjykatësit e GjTh në Mitrovicë (dhe degët e saj) me mesatarisht **264,83** lëndë



Grafika 2. Ngarkesa individuale me lëndë DP për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021

Numri i madh i lëndëve në punë paraqet pengesë serioze për procedimin efikas të rasteve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm kohor siç parashihet me ligj dhe akte ndërkombëtare. Për më tepër këto të dhëna shpërfaqin faktin se gjykatësit e GjTh në Prishtinë janë të mbingarkuar shumëfish më shumë me lëndë penale të përgjithshme në krahasim me gjykatësit e GjTh në Mitrovicë.

Në rrethana të tilla, KGJK konform mandatit të saj duhet të ndërmarrë veprime imediate dhe konkrete për të adresuar këtë problematikë. Një hap pozitiv në këtë drejtim është shpallja e konkursit nga KGJK për rekrutimin e 54 gjykatësve dhe 70 bashkëpunëtorëve profesional në nëntor të vitit 2021. Mirëpo, shpërndarja e këtyre resurseve duhet bërë medoemos tek gjykatat që janë të mbingarkuara me lëndë.

11.3 Ngarkesa me lëndë të krimeve të rënda (DKR) në gjykatat themelore 2018 – qershor 2021

Sipas raportit statistikor për vitin 2018, DKR-të e GjTh-ve kanë pasur në punë gjithsej 5,431 lëndë të tilla, kanë zgjidhur 1,810 lëndë apo 33.32%, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 3,532 lëndë apo 65.02%. 89 lëndë janë bartur në kompetencë. Në vitin 2019, DKR-të e GjTh-ve kanë pranuar në punë 1,207 lëndë të reja, kanë zgjidhur 1,630 lëndë apo 34.39%, kanë mbetur të pazgjidhura 2866 apo 60.47% të lëndëve, në kompetencë janë dërguar 243 lëndë.³⁷

Gjatë vitit 2020, DKR-të kanë pasur në punë 5,774 lëndë, kanë zgjidhur 1,800 lëndë apo 31.17%, të pazgjidhura kanë mbetur 3,974 lëndë apo 68.83%.³⁸ Ndërsa, gjatë periudhës Janar-Qershor 2021, DKR-të e GjTh në punë kanë pasur gjithsej 5,192 lëndë të tilla, kanë zgjidhur 1,063 lëndë apo 20.47%, të pazgjidhura kanë mbetur 4,129 lëndë apo 79,53%. Sipas këtyre statistikave rezulton se efikasiteti i DKR-ve në vitin 2018 ishte 33.32%, për vitin 2019 34.39%, për vitin 2020 31.17% dhe për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 vetëm 20.47%.

Lëndët	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
2018	4091	1340	5431	1810	3532
2019	3532	1207	4739	1630	2866
2020	4007	1767	5774	1800	3974
Janar-Qershor 2021	3987	1205	5192	1063	4129

Tabela 4. Ngarkesa me lëndë dhe efikasiteti i DKR-ve të GjTh-ve për vitet 2018-Qershor 2021

11.4 Trendi i zgjidhjes së lëndëve DKR për periudhën 2018-qershor 2021

Bazuar në trendin e lëndëve të zgjidhura në raport me ato të pranuar, rezulton se gjatë vitit 2018 DKR e GjTh-ve kanë zgjidhur 470 lëndë më shumë sesa të pranuar në punë. Në vitin 2019, ka rënie të numrit të lëndëve të pranuar, ndërsa janë zgjidhur 423 lëndë DKR më shumë sesa janë pranuar. Në vitin 2020, DKR-të e GjTh-ve kanë zgjidhur vetëm 33 lëndë më shumë sesa janë pranuar, derisa në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021, ky departament ka zgjidhur 142 lëndë më pak se sa lëndët e pranuar në punë.

Për vitin 2018, gjyqtarët e DKR e kanë tejkaluar normën vjetore për 6.7 lëndë, duke kryer mesatarisht 37.7 lëndë, për vitin 2019 kanë zgjidhur mesatarisht 34.7 lëndë apo 3,7 lëndë më

³⁷ Kadriu, M. Përgega, S. “Krimet e Rënda 2019”. Prishtinë. Tetor. 2019. Fq.19.

³⁸ Shënim: Mos përputhjet eventuale të të dhënave janë mos përputhje që derivojnë nga raportet statistikore të KGJK.

shumë se norma vjetore. Për vitin 2020, një gjyqtar i këtij departamenti ka kryer mesatarisht 46.15 lëndë në vit, duke tejkaluar normën orientuese vjetore për 15.15 lëndë.³⁹

Sipas këtyre statistikave, trendi i lëndëve të pazgjdhura nga viti 2018 e deri në vitin 2020 ka shënuar një rritje prej 12.51%. Ngjashëm, trendi i lëndëve të reja të pranuar në punë gjatë kësaj periudhe raportuese ka shënuar një rritje prej 31.86%. Ndërkaq, DKR e gjykatave themelore gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore të vitit 2021, kanë pasur në punë **2,164 lëndë “të vjetra”**, apo përkthyer në përqindje i bie **41.67%** e totalit të lëndëve DKR që gjykatat i kanë pasur në punë gjatë kësaj periudhe raportuese.


Gjykata më e ngarkuar me lëndë në punë të DKR gjatë vitit 2020 ka qenë GjTh në Prishtinë me gjithsej 2,179 (37.73% të totalit të lëndëve të krimeve të rënda), ndërsa më pak e ngarkuar me lëndë të tilla ishte GjTh në Gjakovë me 307 lëndë (5.31% e totalit të lëndëve). Situata identike është edhe për periudhën Janar-Qershor.

DKR	2020	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjdhura	Janar-Qershor 2021	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjdhura
GjTh Prishtinë		1595	584	2179	710	1469		1475	391	1866	288	1578
GjTh Mitrovicë		1332	269	1601	256	1345		1329	142	1471	169	1302
GjTh Gjilan		313	184	497	190	307		308	184	492	122	370
GjTh Prizren		189	171	360	165	195		201	131	332	110	222
GjTh Gjakovë		146	161	307	158	149		152	94	246	99	147
GjTh Pejë		165	221	386	160	226		230	119	349	168	181
GjTh Ferizaj		267	177	444	161	283		292	144	436	107	329
Totali		4007	1767	5774	1800	3974		3987	1205	5192	1063	4129

Tabela 5. Ngarkesa e GjTh-ve me lëndë DKR për vitin 2020 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2021


³⁹ Sipas rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, e miratuar nga KGJK më 14.09.2011, norma mujore e një gjyqtari në DKR është 3, ndërsa norma vjetore 31.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, gjykata më e ngarkuar me lëndë të “vjetra” DKR del se është GjTh në Mitrovicë (me degë) me gjithsej 794 lëndë “të vjetra”, ndërsa më së paku lëndë të vjetra të DKR-së rezultojnë të ketë GjTh në Gjakovë (me degë) me vetëm 43 lëndë të tilla.



Grafika 3. Ngarkesa me lëndë “të vjetra” DKR në gjykatat themelore për periudhën Janar-Qershor 2021

Sipas statistikave zyrtare të KGJK për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 rezultojnë se gjykatësit me të ngarkuar me lëndë të DKR janë nga GjTh në Mitrovicë me një mesatare prej 245.16 lëndëve, ndërsa me më pak lëndë të tilla janë ngarkuar gjykatësit nga GjTh në Pejë me 69,8 lëndë.



Grafika 4. Ngarkesa mesatare me lëndë të DKR për një gjyqtar, Janar-Qershor 2021

11.5 Ngarkesa me lëndë civile në gjykata themelore dhe degë për vitet 2018 - qershor 2021

Për vitin 2018, gjykatat e shkallës së parë në punë kanë pasur 70,533 lëndë civile, kanë zgjidhur 21,337 apo 30.25%, ndërsa të pazgjidhura kanë mbetur 49,196 lëndë civile apo 69.75%.

Gjatë vitit 2019, në punë kanë qenë gjithsej 77,964, lëndë civile. Nga ky total i lëndëve civile që kanë pasur në punë, gjykatat kanë zgjidhur 25,186 lëndë civile apo 32.30%, të pazgjidhura kanë mbetur 52,778 lëndë civile apo 67.7%. Sa i përket vitit 2020, gjykatat kanë pasur në punë 97,464 lëndë civile, janë zgjidhur 23,080 lëndë apo 23.68%, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 74,384 lëndë civile apo 76.32%. Për periudhën Janar-Qershor të vitit 2021 gjykatat kanë pasur në punë 111,717 lëndë civile, nga të cilat kanë zgjidhur 16,563 lëndë civile apo 14.82%, derisa të pazgjidhura kanë ngelur 95,154 lëndë civile apo 85.18%.⁴⁰

Sipas këtyre statistikave del se efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve civile në punë për vitin 2018 ka qenë 30.25%, për vitin 2019 ishte 32.30%, për vitin 2020 ka qenë 23.68% dhe për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 është 14.82%.

Lëndët	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
2018	46,152	24,381	70,533	21,337	49,196
2019	49,194	28,770	77,964	25,186	52,778
2020	59,032	38,432	97,464	23,080	74,384
Janar-Qershor 2021	74,196	37,414	111,717	16,563	95,154

Tabela 5. Ngarkesa me lëndë dhe efikasiteti i gjykatave me lëndë civile për periudhën 2018-Qershor 2021

11.6 Trendi i procedimit me lëndë civile për periudhën 2018-qershor 2021

Nëse analizojmë trendin e lëndëve civile të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranuar në punë rezulton se gjykatat në vitin 2018 kanë zgjidhur 3,044 lëndë më pak se ato të pranuar. Për vitin 2019, kemi një trend negativ ashtu që gjykatat kanë zgjidhur 3,584 lëndë më pak sesa të pranuar. Në vitin 2020, kemi rritje të numrit të lëndëve të pranuar dhe rënie të zgjidhjes së lëndëve, ashtu që janë zgjidhur 15,352 lëndë më pak se sa të pranuar. Sa i përket gjashtë mujorit të parë, del se janë zgjidhur 20,851 lëndë më pak se sa të pranuar.

Ndërsa, Trendi i lëndëve të pazgjidhura ka shënuar rritje nga viti 2018 e deri në fund të vitit 2020 për 51.19%, derisa trendi i lëndëve të zgjidhura nga viti 2018 deri në vitin 2020 ka shënuar një rritje të ndjeshme prej 8.16%. Trendit i lëndëve të pranuar, gjatë periudhës raportuese 2018-2020, ka shënuar rritje prej 57.63%.

⁴⁰ Shënim: Mos përputhjet eventuale të të dhënave janë mos përputhje që derivojnë nga raportet statistikore të KGJK-së.

DC	2020	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura	Janar-Qershor 2021	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
		GjTh Prishtinë	25335	13300	38635	7268		31367	31362	11781	43143	5135
GjTh Mitrovicë	6485	4319	10804	2928	7876	7760	5396	13156	2355	10801		
GjTh Gjilan	5555	5119	10654	2106	8568	8557	2206	10843	1733	9110		
GjTh Prizren	5521	4469	9990	2581	7409	7395	4369	11764	1618	10146		
GjTh Gjakovë	4919	2880	7799	2252	5547	5583	4729	10312	1727	8585		
GjTh Pejë	6963	5194	12157	3513	8644	8599	4651	13277	2470	10807		
GjTh Ferizaj	4254	3151	7405	2432	4973	4940	4282	9222	1525	7697		
Total		59032	38432	97444	23080	74384		74196	37414	111717	16563	95154

Tabela 6. Ngarkesa dhe efikasiteti i GjTh-ve me lëndë civile për periudhën 2020 – Qershor 2021


Gjykata më e ngarkuar me lëndë civile gjatë vitit 2020 është GjTh në Prishtinë me gjithsej 38,635 lëndë në punë gjatë kësaj periudhe apo 39.64% e totalit të lëndëve në punë në tërë gjykatat dhe degët), derisa ajo më së paku e ngarkuar është GjTh në Ferizaj me 7,405 lëndë civile, që përbën 7.59% të totalit të këtyre lëndëve në tërë gjykatat. Situatë identike është edhe në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021.

Për vitin 2018, gjykatësit e këtij divizioni të gjykatave kanë zgjidhur 231.9 lëndë civile apo 97.1 lëndë më pak sesa norma vjetore. Në vitin 2019, ndonëse janë shtuar 17 gjyqtar të ri në këtë divizion, del se mesatarisht një gjyqtar ka zgjidhur 254.7 lëndë civile apo 74.3 lëndë më pak sesa norma vjetore. Në vitin 2020, një gjyqtar ka kryer mesatarisht 100.5 lëndë më pak sesa norma vjetore e përcaktuar, apo 228.51 lëndë civile.⁴¹

Sipas statistikave të publikuara nga KGjK për periudhën Janar-Qershor 2021 rezulton se sistemi gjyqësor ka pasur gjithsej **25,764** lëndë “të vjetra” civile në punë, që përbëjnë **23.06%** të totalit të lëndëve në punë gjatë kësaj periudhe. Gjykata më e ngarkuar me lëndë të tilla gjatë kësaj periudhe rezulton të jetë GjTh në Prishtinë me degët e saj me gjithsej 13,360 lëndë “të


⁴¹ Rregullorja për Caktimin e Normave të Punës së Gjyqtarëve e miratuar nga KGjK më 2011, përcakton që gjykatësit të zgjidhin brenda muajit 27 lëndë civile apo 329 lëndë në vit.

vjetra”, ndërsa ajo më pak e ngarkuar me lëndë të tilla për këtë periudhë raportuese është GjTh e Ferizaj me vetëm 1,009 lëndë “të vjetra” civile.



Grafikoni 5. Ngarkesa me lëndë “të vjetra” civile e gjykatave dhe degëve për periudhën Janar-Qershor 2021

Ndërkaq, bazuar në numrin e lëndëve në punë gjatë periudhës Janar-Qershor 2021 rezultojnë se gjykatësit më të ngarkuar me lëndë civile janë nga GjTh në Mitrovicë dhe degët e saj, ku një gjyqtar rezultojnë të jetë i ngarkuar mesatarisht me **1,252 lëndë** në punë gjatë kësaj periudhe raportuese gjashtë mujore. Ndërsa, gjyqtarët e GjTh në Gjilan dhe degët e saj del se kanë qenë më pak të ngarkuar me lëndë civile me një mesatare prej 756,66 lëndë për një gjyqtar për këtë periudhë.



Grafika 6. Ngarkesa mesatare me lëndë civile për një gjyqtar për periudhën Janar-Qershor 2021

12. Ngarkesa dhe efikasiteti me lëndë i Gjykatës së Apelit për vitet 2018-qershor 2021

Gjykata e Apelit gjatë vitit 2018 kishte arritur të zgjidh 13,647. Në punë gjatë kësaj periudhe Apeli ka pasur 26,604 lëndë, derisa të pazgjidhura në fund të kësaj periudhe kanë mbetur 12,957 lëndë. Apeli në këtë vit ka zgjidhur 51.30% të lëndëve në punë, ndërsa 48.70% kanë mbetur të pazgjidhura. Në vitin 2019, Apeli ka pasur në punë ka pasur 29,238 lëndë. Gjatë këtij

viti Apeli ka zgjidhur 17,598 lëndë apo 60.19% të lëndëve në punë, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 11,640 apo 39.81%.

Në vitin 2020, Apeli kishte arritur të zgjidh 15,048 lëndë apo 58,20% të lëndëve në punë. Në punë për këtë periudhë ka pasur 25,859 lëndë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura 10,811 lëndë apo 41.80%. Sa i përket gjashtë mujorit të parë të vitit 2021, Apeli ka pasur në punë gjithsej 19,931 lëndë, nga të cilat zgjidhur 7,839 lëndë apo 39.33% të lëndëve në punë, derisa të pazgjidhura në fund të këtij gjashtë mujori kanë mbetur 12,092 lëndë apo 60.67%.

Efikasiteti i Apelit në zgjidhjen e lëndëve në punë për vitin 2018 ishte 51.30%, për vitin 2019 60.19%, për vitin 2020 ishte 58.20%, ndërsa i përket gjashtë mujorit të parë të vitit 2021 ka zgjidhur 39.33% të lëndëve që i kanë pasur në punë.

Sipas këtyre statistikave del se Apeli në vitin 2018 ka zgjidhur 381 lëndë më pak sesa i ka pranuar, në vitin 2019 ka zgjidhur 1,317 më shumë sesa të pranuar, në vitin 2020 ka zgjidhur 829 lëndë më shumë. Në vitin 2018 në GjA kanë qenë të angazhuar 41 gjykatës, në vitin 2019 kemi rritje të numrit të gjykatësve në 51, në vitin 2020 po ashtu kanë qenë 51 gjykatës të angazhuar që kanë zgjidhur lëndë, ndërsa në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 figurojnë 47 gjykatës të angazhuar në Apel.

Sa i përket trendit të lëndëve të pazgjidhura nga viti 2018 e deri në vitin 2020 rezulton se kemi rënie prej 16.56%, ndërsa numri i lëndëve të pranuar në punë për këtë periudhë raportuese ka shënuar ngritje prej 1.36%.

12.1 Ngarkesa e Apelit me lëndë DP për periudhën 2018 – qershor 2021

Gjykata e Apelit në fillim të vitit 2018 në punë kishte pasur gjithsej 1,735 lëndë DP, kishte zgjidhur 1,443 lëndë apo 83.17%, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 292 lëndë apo 16.83%. Divizioni Penal i GjA, gjatë vitit 2019 kishte arritur të zgjidh 1,558 lëndë apo 79.93%, nga gjithsej 1,949 lëndë në punë, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 391 lëndë të tilla apo 20.07%.⁴² Gjatë vitit 2020, DP i Apelit ka pasur në punë gjithsej 1,715 lëndë. Gjatë kësaj periudhe, ky divizion i Apelit kishte zgjidhur 1,209 lëndë DP apo 70.50%, ndërsa të pazgjidhura kanë mbetur edhe 506 lëndë apo 29.50%.

DP i Apelit gjatë mujorit të parë të vitit 2021 ka pasur në punë gjithsej 1,354 lëndë DP, ka zgjidhur 814 sosh apo 60.12%, derisa në fund të periudhës raportuese si të pazgjidhura kishin mbetur 540 lëndë apo 39.88%.

⁴² Bajraktari, L. “Drejtësia në shkallë të dytë”. Prishtinë. Mars. 2020. Fq.15.

Apel DP	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
2018	379	1356	1735	1443	292
2019	292	1657	1949	1558	391
2020	391	1324	1715	1209	506
Janar-Qershor 2021	506	848	1354	814	540

Tabela 6. Ngarkesa dhe efikasiteti i GjA me lëndë të DP-ve për vitin 2020 -Qershor 2021

Nëse analizojmë numrin e lëndëve DP të zgjidhura në raport me ato të pranuar nga Apeli, rezulton se kjo gjykatë gjatë vitit 2018 ka zgjidhur 87 lëndë më shumë se sa i ka pranuar, për vitin 2019, Apeli ka zgjidhur 99 lëndë më pak DP se sa i ka pranuar, e ngjashëm edhe në vitin 2020 ka zgjidhur 115 lëndë më pak sesa i ka pranuar. Sa i përket gjashtë mujorit të parë të vitit 2021, Apeli ka zgjidhur 34 lëndë DP më pak sesa të pranuar në punë.

Sa i përket numrit të lëndëve DP të pazgjidhura në fund të periudhave raportuese, nga viti 2018 e deri në vitin 2020, kemi një rritje prej **73.28%** të numrit të lëndëve të pazgjidhura. Ndërsa, numri i lëndëve DP të pranuar nga Apeli për periudhën 2018-2020 ka shënuar rënie prej **2.35%**.

12.2 Ngarkesa e Apelit me lëndë civile për periudhën 2018 – qershor 2021

Sa i përket lëndëve civile duhet theksuar se Divizioni Civil i GjA në vitin 2018 në total ka pasur në punë 17,012 lëndë civile, ka zgjidhur 5,461 lëndë apo 32.10%, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 11,551 lëndë apo 67.90%. Në vitin 2019 ky divizion i Apelit ka pasur në total 18,344 lëndëve civile në punë, kishte zgjidhur 8,428 lëndë apo 45.95%, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 9,916 lëndë apo 54.06%.

Sa i përket vitit 2020, ky divizion i GjA ka pasur në punë gjithsej 16,515 lëndë, ka zgjidhur gjithsej 7,476 lëndë apo 45.24%, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 9,039 lëndë apo 54.73%. Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021, Divizioni Civil i GjA ka pasur në punë gjithsej 13,723 lëndë civile, ka zgjidhur gjithsej 3,536 lëndë apo 25.77%, derisa të pazgjidhura në fund të qershorit kanë mbetur 10,187 lëndë civile të shkallës së dytë apo 74.23%.

Apel DC	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
2018	11325	5687	17012	5461	11551
2019	11551	6793	18344	8428	9916
2020	9916	6599	16515	7476	9039
Janar-Qershor 2021	9039	4684	13723	3536	10187

Tabela 7. Ngarkesa dhe efikasiteti i GjA me lëndë civile për vitin 2020 dhe Janar-Qershor 2021

Efikasiteti i Apelit për zgjidhjen e lëndëve civile në punë për vitin 2018 ishte 32.10%, për vitin 2019 ishte 45,95%, për vitin 2020 ka qenë 45.24 dhe për Janar-Qershor 2021 ishte 25.77%.

Nëse përdorim analogjinë e njëjtë, duke krahasuar numrin e lëndëve të zgjidhura civile në raport me ato të pranuar, del se Apeli në vitin 2018 ka zgjidhur 226 lëndë më pak se të pranuar, derisa në vitin 2019 kemi rritje prej 1635 lëndëve më shumë të zgjidhura sesa të pranuar. Në vitin 2020, Apeli ka zgjidhur 877 lëndë civile më shumë se sa i ka pranuar në punë. Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021, nga statistikat rezulton se Apeli ka zgjidhur 1148 lëndë më pak se sa i ka pranuar.

Nëse analizojmë trendin e lëndëve civile të pazgjidhura për periudhën 2018-2020 del se kemi rënie të numrit të lëndëve të pazgjidhura prej 21.74%, derisa gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe rritje prej 16.03% të numrit të lëndëve civile të pranuar.

12.3 Ngarkesa e Apelit me lëndë DKR për periudhën 2018 – qershor 2021

Në vitin 2018, DKR i Apelit ka pasur në punë një total prej 715 lëndëve, kishte zgjidhur 623 lëndë DKR apo 87.13%, derisa të pazgjidhura kishin mbetur 92 lëndë apo 12.87%.

Gjatë vitit 2019, DKR i Apelit ka pasur në punë 752 lëndë, ka zgjidhur 652 lëndë apo 86.79% të lëndëve në punë, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 100 lëndë apo 13.21%.

Ndërsa, vitin 2020 DKR i Apelit ka pasur në punë gjithsej 572 lëndë të krimeve të rënda. Gjatë vitit 2020, ky divizion ka zgjidhur gjithsej 457 lëndë DKR apo 79.89%, derisa të pazgjidhura kanë mbetur 115 lëndë apo 20.11%. Ndërsa, sa i përket gjashtë mujorit të parë të vitit 2021, DKR e Apelit ka pasur në punë një total prej 381 lëndëve, derisa ka arritur të zgjidhë gjithsej 284 prej tyre, ndërsa të pazgjidhura kanë mbetur 97 sosh, me një efikasitet prej 74,54% të zgjidhjes së lëndëve. Lëndë në kuadër të këtij departamenti kanë kryer edhe gjykatës e departamentit special të Apelit.

Apel DKR	Të trashëguara	Të pranuar	Në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura
2018	79	636	715	623	92
2019	92	660	752	652	100
2020	90	482	572	457	115
Janar-Qershor 2021	115	266	381	284	97

Tabela 8. Ngarkesa dhe efikasiteti i GJA me lëndë të DKR për vitin 2020 dhe Janar-Qershor 2021


Për vitin 2018, sipas statistikave të KGJK-së del se Apeli ka zgjidhur 13 lëndë DKR më pak sesa i ka pranuar në punë. Ngjashëm, për vitin 2019 Apeli i ka zgjidhur 8 lëndë më pak të krimeve të rënda sesa të pranuar. Në vitin 2020 Apeli ka zgjidhur 25 lëndë më pak, e sa i përket gjashtë mujorit të parë të vitit 2021 janë zgjidhur 18 lëndë më shumë sesa janë pranuar.

Ndërkaq, nëse analizojmë trendin e lëndëve DKR që kanë mbetur të pazgjidhura, për periudhën 2018-2020 del është rritur për 25% numri i lëndëve të pazgjidhura. Sa i përket lëndëve të pranuar në punë për këtë periudhë raportuese kemi një rënie të ndjeshme prej 24.21 të këtyre lëndëve të pranuar.

13. Shtyrja e seancave gjyqësore tek raste penale, civile dhe krime të rënda

Një ndër faktorët që cenon dhe pengon realizimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor është edhe shtyrja e seancave gjyqësore. Shtyrjet e vazhdueshme të seancave gjyqësore ndikojnë negativisht në realizimin e qasjes efektive në drejtësi dhe i kontribuojnë zvarritjes së trajtimit të një çështje nga gjykata, sidomos kur kihet parasysh numri i madh i lëndëve në punë që ka gjyqësori.


Gjatë vitit 2019, IKD ka monitoruar 3,426 seanca gjyqësore në Divizionet Penale të gjykatave themelore dhe degëve të tyre, të cilat përbëjnë 2,435 raste të trajtuara në këtë departament. Prej këtyre 3,426 seanca, 2,371 seanca janë mbajtur apo 69.20%, ndërsa 1,055 janë shtyrë apo 30.80%. Ndërsa, gjatë vitit 2020 IKD ka monitoruar 1,609 seanca DP me gjithsej 1,189 raste. Nga ky total i seancave, 1,074 janë mbajtur apo 66.75%, derisa 535 janë shtyrë apo 33.25%. Sa i përket periudhës kohore 1 Janar-30 Nëntor 2021, rezulton të jenë monitoruar 2,137 seanca DP me 1,468 raste, nga të cilat 1,327 seanca janë mbajtur, ndërsa 810 janë shtyrë apo 37.90%.⁴³



Grafika 5. Seancat e monitoruara nga IKD në DP për periudhën 2019-Nëntor 2021


Sa i përket rasteve që gjykohen në Divizionin Civil, IKD gjatë vitit 2019 ka monitoruar gjithsej 1,713 seanca, nga të cilat 1,335 janë mbajtur apo 77.93%, derisa 378 janë shtyrë apo 22.07%. Për vitin 2020, IKD kishte monitoruar 978 seanca civile, nga të cilat 748 ishin mbajtur apo 76.48%, ndërsa 230 ishin shtyrë, apo 23.52%. Sa i përket periudhës 1 Janar- 30 Nëntor 2021 rezulton se IKD ka monitoruar 1,020 seanca, nga të cilat 793 ishin mbajtur apo 77.75%, ndërsa 227 ishin shtyrë apo 22.25% e tyre.

⁴³ "Platforma e monitorimit të gjyqësorit". Instituti i Kosovës për Drejtësi (Shih linkun <https://kli-ks.org>). (Qasur së fundi më 28 nëntor 2021)



Grafika 6. Seancat e monitoruara nga IKD në DC për periudhën 2019-Nëntor 2021

Sa i përket krimeve të rënda, IKD gjatë vitit 2019 ka monitoruar 2,229 seanca të DKR nga të cilat 1,680 janë mbajtur apo 75.37%, ndërsa 549 janë shtyrë apo 24.63%. Për vitin 2020, IKD ka monitoruar 1,484 seanca të krimeve të rënda, ku prej tyre, 1,020 janë mbajtur apo 68.74%, ndërsa 464 janë shtyrë apo 31.26%. Për periudhën 1 Janar – 30 Nëntor 2021, IKD ka monitoruar 1,646 seanca të DKR, nga të cilat 1,214 janë mbajtur apo 73.76%, derisa 432 janë shtyrë apo 26.24%



Grafika 7. Statistika mbi seancat e monitoruara nga IKD në DKR për periudhën 2019-Nëntor 2021

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka mbajta e gjykimeve në realizimin e së drejtës për gjykim të drejtës, është e domosdoshme që KGjK të gjenerojë statistika të tilla lidhur me numrin e seancave që dështojnë të mbahen dhe për shkaqet, e konform të gjeturave të ndërmarr veprime konkrete.

Shkaqet që sjellin deri tek shtyrja e seancave janë të ndryshme, duke filluar nga mungesa e palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, mungesa e stafit profesional, mungesa e sallave të gjyqimit, e deri tek arsyet e tilla siç janë mos dorëzimi i rregullt i thirrjes për seancën gjyqësore, për shkak të adresave jo të sakta e arsye të tjera, mos pajisja me kohë e palëve me shkresat e lëndës, vonesat në realizimin e ekspertizave në çështjet civile, mos realizimi i urdhëresave për sjellje të detyrueshme të pjesëmarrësve në procedurë penale, pastaj pjesëmarrja në trajnime e gjykatësve e pjesëmarrësve të tjerë, mungesa e një plani konkret për trajtimin e rastit, mos menaxhimi pro-aktiv i çështjeve nga gjyqtarët etj.

14. Ping-pongu me lëndët gjyqësore zvarrit pa arsye procedurat gjyqësore

Një ndër faktorët kryesorë që i kontribuon zvarritjes së procedurave gjyqësore është edhe “ping-pongu” me lëndët gjyqësore ndërmjet gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit si gjykatë e shkallës së dytë. Pra, kthimi i shpeshtë i lëndëve në rigjykim, pamundëson që një çështje e caktuar të marr formë të prerë dhe për pasojë, ai vendim gjyqësor nuk bëhet i ekzekutueshëm deri sa çështja të vendoset në shkallë të dytë.

Pra, Gjykata e Apelit, ndonëse me ligj ka të gjitha autorizimet që të vendos në mënyrë meritore për vendimin i cili ankimohet, kthen ato lëndë në rigjykim. Një praktikë e tillë e cila aplikohet nga Apeli ndikon që lënda e kthyer në rigjykim të merr numër të ri të lëndës dhe praktikisht të trajtohet si lëndë e re, e cila duhet të pres radhën për vendosje.

Ndonëse kthimi i një lëndë në rigjykim nuk përbën shkelje ligjore, praktika gjyqësore ka dëshmuar se rigjykimi si i tillë, i cili në raste të caktuara aplikohet disa herë tek i njëjti rast dhe për të njëjtat shkelje, zvarrit procedurën gjyqësore si të tillë dhe për më tepër ngarkon edhe gjykatat e shkallës së parë me lëndë.

Për vitin 2018, në çështjet civile kemi vërtetim të aktgjyqësive nga Apeli në 3,376 raste, abrogim apo kthim të rasteve në rigjykim në 1,451 raste, ndryshim të vendimeve të shkallës së parë në 421 raste dhe në 213 raste kemi hudhje poshtë të ankesave. Gjatë kësaj periudhe raportuese, rastet e kthyer në rigjykim arrijnë vlerën 26.57% e totalit të lëndëve të zgjidhura civile.⁴⁴

Për vitin 2019, GjA ka vërtetuar aktgjykimin e themelores në 5,041 raste, pastaj ka kthyer në rigjykim 2,368 vendime të shkallës së parë, në 744 raste kemi ndryshim të vendimeve të themelores dhe në 275 lëndë civile është hudhur poshtë ankesa. Pra, gjatë këtij viti, 28.09% e lëndëve civile janë kthyer në rigjykim nga Apeli. Sipas këtyre statistikave, nëse analizojmë trendin e kthimit të rasteve në rigjykim nga viti 2017 e deri në vitin 2019 rezulton se kemi një rritje prej 91.89% të vendimeve me të cilat anulohen aktgjykimet civile dhe lënda i kthehet shkallës së parë për vendosje.

Ndërsa, statistikat për vitin 2020 nuk kanë qenë të gjeneruara nga zyra e statistikave të Apelit në momentin e parashtrimit të kërkesës për qasje në statistika të tilla.

Vendimi i Apelit (DC)	Vërtetim	Abrogim	Ndryshim	Hudhje e ankesës
2018	3376	1451	421	213
2019	5041	2368	744	275

Tabela 9. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve civile nga Apeli për vitet 2018-2019

Sa i përket procedurës ankimore tek rastet penale të përgjithshme (DP), bazuar në statistikat e Apelit, rezulton se gjatë vitit 2018 janë vërtetuar 977 vendime të gjykatave themelore, pastaj

⁴⁴ Përgjigje nga GjA për IKD. 19.11.2021.

janë abroguar apo kthyer në rigjykim 187 vendime të DP-ve, janë ndryshuar 202 vendime të shkallës së parë dhe në 78 raste Apeli ka hudhur poshtë ankesën. Përkthyer në përqindje i bie që gjatë vitit 2018 Apeli ka kthyer në rigjykim 12.95% të lëndëve të zgjidhura të DP.

Për vitin 2019, Apeli ka vërtetuar 985 aktgjykime të shkallës së parë të DP-ve, ka abroguar apo kthyer në rigjykim 300 raste, pastaj 212 vendime të gjykatave themelore janë ndryshuar dhe në 61 raste ankesa është hudhur poshtë. Gjatë kësaj periudhe, Apeli ka kthyer në rigjykim 19.25% të lëndëve të zgjidhura të DP.

Gjatë vitit 2020 Apeli ka vërtetuar 740 aktgjykime të shkallës së parë të DP-ve, ka abroguar apo kthyer në rigjykim 247 vendime të gjykatave themelore, pastaj ka ndryshuar 176 vendime dhe në 46 raste ankesa është hedhur poshtë. Në përqindje i bie që gjatë vitit 2020 Apeli ka kthyer në rigjykim 20.43% të lëndëve të DP. Sipas këtyre statistikave rezulton se trendi i Apelit për kthim të çështjeve penale të përgjithshme në rigjykim për periudhën 2018-2020 ka shënuar rritje prej 32.08%.

Vendimi i Apelit (DP)	Vërtetim	Abrogim	Ndryshim	Hudhje e ankesës
2018	977	187	202	78
2019	985	300	212	61
2020	740	247	176	46

Tabela 10. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve DP nga Apeli për vitet 2018-2020

Sa i përket procedurës ankimore tek lëndët e DKR-së, bazuar në statistikat rezulton se Apeli gjatë vitit 2018 ka vërtetuar 360 aktgjykime të gjykatave themelore, ka abroguar apo kthyer në rigjykim 107 vendime të shkallës së parë, 93 vendime janë ndryshuar dhe 28 raste ankesa është hudhur poshtë nga Apeli. Gjatë vitit 2018, Apeli ka kthyer në rigjykim 17.37% të lëndëve të zgjidhura të DKR.

Për vitin 2019, 382 vendime të gjykatave themelore tek lëndët DKR janë vërtetuar nga Apeli, 147 vendime të shkallës së parë janë kthyer në rigjykim, 109 vendime janë ndryshuar dhe 14 ankesa janë hedhur poshtë. Përkthyer në përqindje, i bie që gjatë këtij viti Apeli ka kthyer në rigjykim 22.54% të lëndëve të zgjidhura të DKR.

Gjatë vitit 2020 Apeli ka vërtetuar 330 aktgjykime të shkallës së parë të lëndëve DKR, 102 vendime të shkallës së parë janë kthyer në rigjykim, 67 vendime dhe 8 ankesa janë hedhur poshtë nga Apeli. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Apeli ka kthyer në rigjykim 20.11% të lëndëve të zgjidhura të DKR.

Sipas këtyre statistikave rezulton se trendi i Apelit për të kthyer lëndë të krimeve të rënda në rigjykim për periudhën 2018-2020 ka shënuar rënie prej 4.67%.

Vendimet e Apelit (DKR)	Vërtetim	Abrogim	Ndryshim	Hudhje e ankesës
2018	360	107	93	28
2019	382	147	109	14
2020	330	102	67	8

Tabela 11. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve DKR nga Apeli për vitet 2018-2020

12. Analiza e kohëzgjatjes së gjykimeve në themelore e Apel, në DP, DC dhe DKR sipas vendimeve gjyqësore

IKD për qëllime të këtij hulumtimi ka analizuar 300 vendime gjyqësore të përzgjedhura në mënyrë rastësore, për të pasqyruar kohëzgjatjen mesatare të gjykimeve në procedurë penale, DP dhe DKR dhe procedurë civile në shkallë të parë dhe të dytë në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, duke filluar nga momenti i ushtrimit të aktakuzës tek rastet penale, respektivisht padisë në gjykatë tek çështjet civile.

Nga 50 aktgjykimet e analizuar të nxjerra në shkallë të parë nga DP-të e gjykatave themelore dhe degët e tyre, rezulton se nga ngritja e aktakuzës e deri në përfundimin e gjykimit në shkallë të parë sistemit gjyqësor i janë nevojitur mesatarisht **2309** ditë apo më shumë se **6 vite**.

P.nr.164/2014	P.nr.4211/16	P.nr.1965/12	P.nr.1494/13	P.nr.696/14	P.nr.3023/14	P.nr.2992/14
P.nr.3877/15	P.nr.4211/16	P.nr.3980/15	P.nr.489/2015	P.nr.65/2016	P.nr.293/2016	P.nr.282/2016
P.nr.302/2016	P.nr.236/2016	P.nr.233/2016	P.nr.40/2016	P.nr.230/2016	P.nr.554/2020	P.nr.602/17
P.nr.1389/12	P.nr.1051/15	P.nr.2721/17	P.nr.714/17	P.nr.286/13	P.nr.468/18	P.nr.597/17
P.nr.306/2019	P.nr.434/17	P.nr.576/16	P.nr.624/2015	P.nr.694/18	P.nr.717/17	P.nr.1245/2017
P.nr.207/2013	P.nr.384/2012	P.nr.308/2012	P.nr.801/2016	P.nr.203/2013	P.nr.301/2017	P.nr.351/2017
P.nr.477/2015	P.nr.203/17	P.nr.217/17	P.nr.288/13	P.nr.95/18	P.nr.275/16	P.nr.497/2015
P.nr.242/2017						

Tabela 12. Aktgjykimet DP të analizuar nga ngritja e aktakuzës e deri tek vendimi i shkallës së parë

Sa i përket 50 aktgjykimeve DKR-ve të analizuar rezulton se që nga ngritja e aktit akuzues e deri në nxjerrjen e vendimit të shkallës së parë gjykatave u janë dashur mesatarisht **2158 ditë** apo afro **6 vite**.

PKR.nr.18/2020	PKR.nr.65/2021	PKR.nr.113/2021	PKR.nr.130/19	PKR.nr.244/2013	PKR.nr.144/16	PKR.nr.131/2021
PKR.nr.267/19	PKR.nr.302/19	PKR.nr.757/16	PKR.nr.639/20	PKR.nr. 184/ 15	PKR.nr.215/2018	PKR.nr.8/2020
PKR.nr.19/17	PKR.nr.11/2020	PKR.nr.175/2013	PKR.nr.61/2015	PKR.nr.29/2014	PKR.nr.202/2019	PKR.nr.2/2021
PKR.nr.36/2021	PKR.nr.80/2021	PKR.nr.66/2019	PKR.nr.142/2021	PKR.Nr.32/2019	PKR.nr.87/16	PKR.nr.51/18
P.nr.94/17	P.nr.127/2017	P.nr.834/06 PR1	PKR.nr.152/15	PKR.nr.108/16	P.nr.406/05/PR1	PKR.nr.37/17
PKR. nr. 148/2016	P.nr.581/17	P.nr 370/12-PR1	PKR.nr.204/17	PKR175/15	PKR.nr.32/17	PKR. nr. 39/18
PKR. nr. 89/16	PKR.nr. 32/2015	P.nr. 126/2013	PKR.nr.112/2016	PKR.nr. 132/2013	PKR.nr.206/2014	PKR.nr. 247/2014
PKR.nr.219/16						

Tabela 13. Aktgjykimet e analizuara nga ngritja e aktakuzës e deri tek vendimi i shkallës së parë

Nga vendimet e analizuara rezulton se një proces gjyqësor në shkallë të parë tek rastet civile ka zgjatur **1755 ditë** apo **4.8 vite**. Ndërsa, nga nxjerra e vendimit në shkallë të parë e deri tek nxjerra e vendimit gjyqësor të formës së prerë gjykatave të Divizionit Civil u janë nevojitur **1282 ditë** apo **3.5 vite**.

Ac.nr.6475/2020	Ac.nr.2912/18	Ac.nr.3133/2018	Ac.nr.5412/18	Ac.nr.140/19	Ac.nr.408/19	A.C.nr.4289/18
Ac.nr.4306/18	Ac.nr.404/19	Ac.nr.3511/19	Ac.nr.2605/19	Ac.nr.101/18	Ac.nr.1808/18	Ac.nr.2258/17
Ac.nr.2580/16	Ac.nr.3842/17	Ac.nr.5350/17	Ac.nr.4168/20	Ac.nr.4446/20	Ac.nr.4956/17	Ac.nr.5022/19
Ac.nr.3609/18	Ac.nr.3710/19	Ac.nr.3758/19	Ac.nr.423/2018	Ac.nr.3384/18	Ac.nr.580/19	Ac.nr.4973/18
Ac.nr.3505/18	Ac.nr.4662/2018	A.C.nr.3573/2017	Ac.nr.2317/18	Ac.nr.4200/16	Ac.nr.4816/17	Ac.nr.3483/17
Ac.nr.5433/18	Ac.nr.999/17	Ac.nr.2753/18	Ac.nr.4857/17	Ac.nr.4569/2017	Ac.nr.5129/18	Ac.nr.5426/2017
Ac.nr.447/2018	Ac.nr.4534/16	Ac.nr.448/16	Ac.nr.4132/19	Ac.nr.372/17	Ac.nr.1678/18	Ac.nr.2501/17
Ac.nr. 741/2017						

Tabela 14. Aktgjykimet e analizuara sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve nga shkalla e parë deri në Apel

Në shkallë të dytë, nga 50 aktgjykimet e DP-ve të analizuara rezulton se nga nxjerrja e vendimit gjyqësor në shkallë të parë e deri në marrjen e formës së prerë së tij, kohëzgjatja mesatare e kësaj procedure është **497 ditë** apo **1.4 vite**.

PA1.nr.564/20 21	PA1.nr.825/20 21	PA1.nr.534/20 21	PA1.nr.464/20 21	PA1.nr.567/20 21	PA1.nr.1291/2 020	PA1.nr.679/202 0
PA1.nr.610/20 20	PA1.nr.991/20 20	PA1.nr.337/20 21	PA1.nr.196/20 21	PA1.nr.760/20 20	PA1.nr.679/20 20	PA1.nr.337/202 1
PA1.nr.657/20 20	PA1.nr.647/20 20	PA1.nr.397/20 20	PA1.nr.865/20 20	PA1.nr.896/20 20	PA1.nr.819/20	PA1.nr.588/20
PA1.nr.1553/2 019	PA1.nr.557/20	PA1.nr.1424/2 019	PA1.nr.1565/2 019	PA1.nr.1566/2 019	PA1.nr.1272/2 019	PA1.nr.1085/19
PA1.nr.1327/1 9	PA1.nr.1329/1 9	PA1.nr.500/20 19	PA1.nr.590/19	PA1.nr.436/19	PA1.nr.557/20 19	PA1.nr.1048/20 18
PA1.nr.125/19	PA1.nr.34/19	PA1.nr.631/16	PA1.nr.469/20 18	PA1.nr.703/20 17	PA1.nr.601/17	PA1.nr.602/17
PA1.nr.365/17	PA1.nr.796/20 16	PA1.nr.1543/2 016	PA1.nr.1407/2 016	PA1.nr.1235/2 020	PA1.nr.978/20 20	PA1.nr.949/21
PA1.nr.964/21						

Tabela 15. Aktgjykimet DP të analizuara sa i përket kohëzgjatjes së gjyqimeve deri në vendimin e Apelit

Tek lëndët e DKR-ve, nga 50 vendimet gjyqësore të analizuara rezulton se deri në marrjen e formës së prerë të vendimit gjyqësor të nxjerrë në shkallë janë nevojitur **252 ditë apo 0.68 vite**.

PAKR.nr.60/20 20	PAKR.nr.422/2 013	PAKR.nr.476/2 013	PAKR.nr.287/1 6	PAKR.nr.634/2 015	PAKR.nr.57/20 17	PAKR.nr.32/201 7
PAKR.nr.132/2 017	PAKR.nr.357/2 019	PAKR.nr.260/2 019	PAKR.nr.215/2 018	PAKR.nr.214/2 018	PAKR.nr.313/1 8	PAKR.nr.220/18
PAKR.nr.440/2 017	PAKR.nr.457/2 017	PAKR.nr.462/2 017	PAKR.nr.389/2 017	PAKR.nr.345/2 017	PAKR.nr.441/2 017	PAKR.nr.444/20 17
PAKR.nr.176/2 017	PAKR.nr.207/2 017	PAKR.nr.383/1 7	PAKR.nr.284/1 7	PAKR.nr.471/2 018	PAKR.nr.70/17	PAKR.nr.418/20 18
PAKR.nr.436/1 8	PAKR.nr.605/2 018	PAKR.nr.80/20 19	PAKR.nr.76/20 19	PAKR.nr.50/19	PAKR.nr.513/2 018	PAKR.nr.35/201 8
PAKR.nr.448/2 017	PAKR.nr.579/1 7	PAKR.nr.504/2 019	PAKR.nr.324/2 017	PAKR.nr.70/17	PAKR nr.377/2017	PAKR nr.378/2017
PAKR.nr.71/20 17	PAKR.nr.332/2 017	PAKR.nr.383/1 7	PAKR.nr.285/2 017	PAKR.nr.496/2 018	PAKR.nr.206/2 018	PAKR.nr.185/20 21
PAKR.nr.448/2 020						

Tabela 16. Aktgjykimet DKR të analizuara sa i përket kohëzgjatjes së gjyqimit deri në vendimin e Apelit.

15. Rekomandimet

• **Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës**

1. KGJK të bëj një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes së gjykatave me lëndë dhe konform të gjeturave të ndërmerren hapa konkret për stabilizimin e gjendjes, duke ndërmarrë masa imediate për zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe balancimin e ngarkesës me lëndë të gjykatave.
2. KGJK të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që proceset gjyqësore të realizohen brenda afateve të arsyeshme dhe që koha e pritjes së lëndëve për tu zgjidhur të reduktohet minimalisht.
3. KGJK të përfshijë e kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në vlerësimin e gjykatësve dhe me rastin e vlerësimit të performancës, të mbajë përgjegjës ata gjykatës që nuk kanë proceduar me lëndë brenda afateve të arsyeshme.
4. KGJK në kuadër të strategjisë së re për reduktimin e lëndëve të vjetra të parashoh një plan konkret veprimi, të mbikqyrë në vazhdimësi implementin e së njëjtës, të parasheh obligime konkrete për kryetarët e gjykatave dhe gjykatësit dhe të mbaj përgjegjës të njëjtit për mos përmbushjen e saj.
5. KGJK të sigurohet që brenda një afati sa më të shpejtë të reduktohet numri i lëndëve të vjetra dhe që të garantoj se po procedohen me prioritet lëndët e vjetra që rrezikojnë parashkrimin.
6. KGJK të zbatojë indikatorë të qartë të cilët mundësojnë llogaritjen e kohëzgjatjes së etapave të veçanta të procesit gjyqësor dhe procesit në tërësi apo për lloje të veçanta çështjesh, që nga hapja e deri në zgjidhjen përfundimtare të rastit dhe të njëjtat të jenë në dispozicion për publikun.
7. KGJK përmes një analizë të gjithmbarshme të identifikoj shkaqet që kanë ndikuar në vonesat e gjykimeve dhe konform të gjeturave të ndërmarr veprime korigjuese.
8. KGJK të mbajë përgjegjës gjyqtarët që nuk kanë arritur të përmbushin normën orientuese vjetore të përcaktuar, por se paraprakisht KGJK të rishikojë rregulloren që përcakton këto norma.
9. KGJK të përfshijë në raportet periodike statistikore edhe të dhëna mbi numrin e seancave të mbajtura dhe të shtyra për secilën gjykatë dhe degë.
10. KGJK të sigurohet që gjykatat do të trajtojnë me prioritet lëndët që janë duke pritur me vite të tëra me qëllim të mos zvarritjes së mëtejme të procedurave gjyqësore. KGJK ta ketë parasysh faktin se zvarritja e lëndëve me dekada cenon rëndë të drejtat dhe liritë e qytetarëve për të pasur një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor.

• **Gjykatën e Apelit:**

1. Gjykata e Apelit të heq dorë nga praktika e kthimit të shpeshtë të rasteve në rigjykim, dhe të marr vendime meritorë kur vlerësohet se shkelja ligjore e evidentuar në vendimin e shkallës së parë është e natyrës së atillë që mund të evitohet nga Apeli.

• **Gjykatat Themelore**

1. Kryetarët e gjykatave duhet të sigurojnë administrimin efikas dhe efektiv të drejtësisë nga të gjitha degët, departamentet dhe divizionet e gjykatës që janë nën menaxhimin e tyre.

2. Kryetarët e gjykatave duhet të kujdesen që ngarkesa e gjykatësve me lëndë të mos jetë pengesë për procedimin efikas të çështjeve.
3. Kryetarët e gjykatave të sigurohen që të gjitha lëndët brenda gjykatës që udhëheqin gjykohen brenda afateve të arsyeshme kohore.
4. Kryetarët e gjykatave të identifikojnë proceset gjyqësore ku potencialisht mund të ketë zvarritje dhe të sigurohen që të njëjtat të procedohen me prioritet.
5. Kryetarët e gjykatave të promovojnë idenë e zbatimit të procedurave alternative, dhe të sigurohen se gjykatësit informojnë qytetarët mbi mundësinë e zbatimit të këtyre procedurave kur e lejon ligji.
6. Kryetarët e gjykatave të informohen mbi shtyrjet e seancave dhe të sigurohen që gjykatësit po ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore ndaj palëve dhe pjesëmarrësve që i kontribuojnë zvarritjes së paarsyeshme së gjykimit.

Ministrinë e Drejtësisë

1. Të procedoj sa më shpejt në Kuvend ligjin i cili parasheh mjete efektive juridike kundër zvarritjes së procedurave gjyqësore, për të siguruar mbrojtjen efektive të së drejtës për gjykim të drejtë.

Avokati i Popullit

1. Institucioni i Avokatit të Popullit të siguroj që të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët sa i përket cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm të trajtohen me prioritet.
2. Të rris aktivitetin e tij në dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e funksionimit të gjyqësorit.
3. Të sensibilizoj opinionin publik mbi mundësinë që të parashtrojnë ankesa në këtë institucion në rastet kur pretendojnë për tejzgjatje të procedurave gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese të trajtoj më me prioritet kërkesat që parashtrohen sa i përket cenimit të së drejtës për gjykim të drejtë të realizuar në afat të arsyeshëm.
2. Gjykata Kushtetuese gjatë trajtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm të marrë për bazë jurisprudencën e GjEDNj, e cila është mjaft e pasur me raste të tilla.

16. Gjetjet e IKD lidhur me trajtimin e rasteve dhe kohëzgjatjen e gjykimeve

IKD në kuadër të këtij raporti ka trajtuar gjithsej 31 raste karakteristike ku pasqyrohet mos procedimi i efikas i lëndëve gjyqësore dhe ku më së miri evidentohet zvarritja e procedurave gjyqësore. Në këtë kapitull përfshihen 12 raste të gjykuara në Departamentin për Krime të Rënda të gjykatave themelore, 9 raste që gjykohen në Departamentin e Përgjithshëm të gjykatave dhe 10 raste civile.

Nga rastet që janë gjykuar në DKR, një prej tyre po procedohet aktualisht për herë të katërt në shkallë të parë, ku i akuzuar për vrasje të rëndë dhe armëmbajtje pa leje është Naser Pajazitaj.

Tre raste të tjera që gjykohen në DKR, si “Çekiçi”, “Medicus” dhe rasti i vrasjes së tashmë të ndjerit Triumf Riza po procedohen për herë të tretë në shkallë të parë, pasi Apeli i kishte kthyer në rigjykim. Tek rasti “Çekiçi”, që nga ngritja e aktakuzës kanë kaluar më shumë se **11 vite, 10 muaj e 11 ditë**, derisa tek rasti “Medicus” kanë kaluar po ashtu **11 vite, 1 muaj e 17 ditë** që nga ushtrimi i aktakuzës.

Ndërkaq, rasti i njohur si “FAN”, ku të akuzuar për korrupsion dhe vepra tjera penale janë ish-deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Osmanit dhe zyrtarë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) Melita Ymeraga, Adrian Kelmendi, Bahri Shabani, Shkëlzen Lluca dhe Naim Avniu, arrin parashkrimin **në janar të vitit 2022**. Në këtë rast ishin nxjerrë një vendim lirues në shkurt të vitit 2019, i cili më pas ishte anuluar nga Apeli dhe ky rast ishte kthyer në rigjykim në mars të vitit 2020.

Mos procedim brenda afatit të arsyeshëm kohor ka pasur edhe tek rasti i të akuzuarve për terrorizëm Frashër Krasniqi dhe tre aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, Adea Batusha, Egzon Haliti dhe Atdhe Arifi. Pas kthimit në rigjykim në vitin 2018, gjykata kishte filluar të procedojë sërish pas dy vitesh, konkretisht në mars të vitit 2020.

Në dy raste të tjera me krim të organizuar, siç është rasti i njohur si “Toka”, dhe rasti “Vizat”, akoma nuk kanë marrë epilog në shkallë të parë, ndonëse këto raste janë duke u proceduar për më shumë se 5 vite në gjykatë.

Në një rast, si pasojë e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore ka ardhur deri tek parashkrimi i dy veprave penale, asaj të pjesëmarrjes në turmën që kryen veprë penale dhe për nxitje të urrejtjes ndaj të akuzuarës Zylahaje Abdullahu. Aktakuza në këtë rast ishte ngritur më 12 nëntor 2009, ndërsa tani e akuzuara Abdullahu po akuzohet vetëm për veprën penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, kur kanë kaluar më shumë se 12 vite nga ngritja e aktakuzës, e seanca e fundit në këtë rast është mbajtur në maj të këtij viti.

Një rast tjetër ku manifestohet zvarritje e procedurës gjyqësore është ai i krimit të organizuar dhe korrupsionit ndaj të akuzuarve Shaip Ferizi, Shqipe Avdiu, Arben Jashari, Mustafë Vitia, Mexhid Mustafa, Besnik Ferizi, Faton dhe Arsim Topanica dhe Ajdar Jashari për akuzën se dëmtuan buxhetin e shtetit mbi 2 milionë euro. Aktakuza në këtë rast ishte ushtruar më 30 dhjetor 2008, ndërsa vendimi në shkallë të parë ishte marrë më 11 mars 2019. Mirëpo, ky rast

ishite kthyer në rigjykim nga Apeli në dhjetor të vitit 2019, e që nga ajo kohë Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka proceduar me këtë lëndë, kur janë bërë dy vite nga kthimi në rigjykim.

Ndër rastet e tilla më karakteristike është edhe i i tre personave të akuzuar për trafikim me qenie njerëzore, rast ky i gjykuar në Gjykatën e Gjilanit. Aktakuza në këtë rast ishte ngritur më 14 shkurt 2006, por se ky rast akoma nuk ka marrë një epilog. Ndonëse të akuzuarit ishin gjetur fajtor në korrik 2006, ky vendim ishte anuluar nga Gjykata Supreme në janar të vitit 2007. Që nga ajo kohë gjykata nuk ka marr vendim edhe kur kanë kaluar më shumë se 15 vite, 9 muaj e 18 ditë.

Sa i përket rasteve që gjykohen në Departamentin e Përgjithshëm të gjykatave, si më karakteristike sa i përket zvarritjes së procedurave gjyqësore kemi evidentuar aktakuzën e ushtruar ndaj Mytaher Haskuka dhe të tjerëve, ku përkundër se kanë kaluar më shumë se 5 vite e 7 muaj nga ushtrimi i aktit akuzues, akoma nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar në këtë rast.

I veçantë në këtë drejtim është edhe rasti i të akuzuarit për detyrim Agim Ademi, ndaj të cilit pas parashkrimit të veprës penale ushtrim i ndikimit, lënda i është deleguar në Departamentin e Përgjithshëm. Rasti ndaj Ademit ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata Supreme në gusht të vitit 2020, por që nga ajo kohë nuk është mbajtur asnjë seancë në këtë rast.

Mos procedim brenda afateve ligjore ka pasur edhe tek rastet ndaj të akuzuarve Gazmend Muhaxheri e Ramiz Kelmendi, si persona me ndikim në jetën publike. Seanca fillestare ndaj Muhaxherit, që akuzohej për mos ekzekutim të vendimeve gjyqësore ishte mbajtur 604 ditë pas dorëzimit të aktakuzës, ndërsa ndaj Kelmendit kjo seancë ishte mbajtur pas më shumë se 5 vite nga ngritja e aktakuzës.

Raste të tjera të gjykuara në DP, janë karakterizuar me parashkrim të ndjekjes penale për shkak të dështimit të gjykatave për të vepruar me kohë. I tillë është rasti i të akuzuarit për asgjësim të pasurisë, ish-ambasadorit të Kosovës në Shqipëri Gazmend Pula, ku lënda e tillë ishte bartur tek gjyqtarë të ndryshëm, për të arritur parashkrimin më 19 tetor 2021, ndonëse akti akuzues ishte ushtruar më 22 dhjetor 2017.

Tek një rast tjetër për rrezikim të trafikut publik, vendimi në shkallë të parë ishte nxjerrë 9 vite pas ngritjes së aktakuzës. Zvarritje të theksuar të procedurës gjyqësore ka pasur edhe në rastin e të akuzuarit për punime ndërtimore të kundërligjshme Zaim Ilazi, dhe aktualisht kjo lëndë është në proces gjyqësor edhe pse kanë kaluar 13 vite, 9 muaj e 13 ditë nga ngritja e aktakuzës dhe ende nuk është nxjerrë epilog në shkallë të parë.

Te rastet civile të përfshira IKD ka gjetur se në secilin rast kemi zvarritje të paarsyeshme të procedurës civile. Prej tyre në 5 raste IKD ka gjetur se procedura civile ka zgjatur më tepër se 10 vite, ndërsa në 5 rastet tjera më pak se 10 vite.

Në 5 rastet e analizuara rezulton Gjykatat e shkallës së parë dhe dytë si pasojë e kundërthënieve në vendimet e tyre gjyqësore kanë kthyer rastin disa herë në rishqyrtim, e cila situatë ka kontribuar në zvarritjen e procedurës civile. Kurse në 2 raste rezulton se seanca përgaditore është caktuar pas 7 viteve, përkundër detyrimit ligjor që seanca të caktohet brenda 30 ditësh.

Annex 1. Analizë e gjykimit të Krimeve të Rënda nga Gjykatat e vendit

1. Rasti “Çekiçi”

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: PKR.nr.835/20

Ngritja e aktakuzës: 21.01.2010

Vepra penale: “Vrasje e rëndë”

I akuzuari: Gëzim Retkoceri

Faza e Procedurës: Rigjykim

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **4,333 ditë** apo **11 vite, 10 muaj e 11 ditë**.

Prokuroria Publike e Qarkut më 21 janar 2010 kishte ngritur aktakuzë me të cilën Gëzim Ratkocerin dhe Osman Spahiun i ngarkonte me veprën penale të vrasjes së rëndë të tani të ndjerit Naim Hajrizin. Sipas aktakuzës, të akuzuarit më 29 prill të vitit 2009, pasi e kishin vrarë tani të ndjerin, e kishin dërguar në një lokacion ndërmjet fshatit Smallushë dhe Dobratin dhe për të fshehur gjurmët, e kishin djegur trupin e tij.

Në këtë rast i akuzuar për vrasje të rëndë në bashkëkryerje ishte edhe Osman Spahiu, por pasi cilësimi të veprës penale nga ana e prokurorisë ai për dhënien e ndihmës në kryerjen e kësaj vepre penale e kishte pranuar fajësinë dhe ishte dënuar me 10 vjet burgim. Duke qenë se Spahiu kishte qenë në paraburgim nga viti 2009 e deri më 21 janar 2020, i njëjti tashmë veç e ka mbajtur dënimin e shqiptuar ndaj tij.

Ky rast është duke u trajtuar për herë të tretë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, pasi Gjykata e Apelit e kishte kthyer dy herë në rigjykim. Fillimisht, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 7 korrik 2015, dy të akuzuarit Retkoceri dhe Spahiu i kishte dënuar me nga 30 vjet burgim. Por ky vendim ishte anuluar nga Gjykata e Apelit më 4 maj të vitit 2016.

Në janar të vitit 2020, GjThP të akuzuarin, Ratkoceri, sërish e kishte dënuar me 30 vjet burgim, pasi e kishte shpallur fajtor për vrasjen e të ndjerit Hajrizi në vitin 2009, në Lipjan. Kolegji i Apelit kishte mbajtur seancën më 15 korrik 2020 pas ankesave të mbrojtjes. Sipas aktgjykimit të Apelit, duke qenë se kjo lëndë edhe njëherë tjetër ishte kthyer në rigjykim në shkallën e parë, kjo e fundit, sipas Apelit, në masë të madhe nuk i kishte përfillur udhëzimet e dhëna nga gjykata e shkallës së dytë.

2. Rasti “Medicus”

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: PKR.nr.315/18

Ngritja e aktakuzës: 15.10.2010

Vepra penale: “*Trafikimi me njerëz*”, “*krimi i organizuar*”

Të akuzuarit: Lutfi dhe Arban Dervishi

Faza e Procedurës: Rigjykim

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **5,066 ditë** apo **11 vite, 1 muaj e 17 ditë**.

PSRK më 15 tetor 2010 kishte ngritur aktakuzë kundër urologut Lutfi Dervishi, djalit të tij Arban Dervishi, mjekëve Driton Jilta dhe Sokol Hajdini, si dhe ish-sekretarit permanent të Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Rrecaj. Pas 5 ditësh, më 20 tetor, ishte ngritur aktakuzë edhe kundër mjekëve Islam Bytyqi dhe Sulejman Dulla. Që të dyja këto ishin bashkuar në një aktakuzë të vetme më 29 nëntor 2010, dhe janë konfirmuar me 27 prill 2011.

Pas 106 seancave gjyqësore të mbajtura, GjTh në Prishtinë më 29 prill 2013 kishte shpallur verdiktin final për këtë rast. Sipas atij aktgjykimi, Lutfi Dervishi ishte dënuar me 8 vjet burg e 10 mijë euro për veprat penale të “trafikimit me njerëz në bashkë-kryerje” dhe “krimit të organizuar”, ndërkaq ishin refuzuar akuzat për “ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore”, “lëndim të rëndë trupor”, “mashttrim” dhe “falsifikim të dokumenteve”. Të njëjtit i ishte shqiptuar edhe dënimi plotësues i ndalimit nga ushtrimi i profesionit të urologut në kohëzgjatje prej dy vitesh. Për të njëjtat vepra penale ishte dënuar edhe djali i tij Arban Dervishi, me 7 vjet e 3 muaj burg dhe me 2.500 euro gjobë. Ndërkaq i njëjti ishte liruar nga akuzat për “lëndim të rëndë trupor”, kurse akuzat për “mashttrim” dhe “falsifikim të dokumenteve” u refuzuan.

Me atë aktgjykim, Sokol Hajdini ishte liruar nga akuza për “krim të organizuar”, por ishte dënuar për veprën penale “lëndim i rëndë trupor” me 3 vjet burg. Ndaj të njëjtit, ishte shqiptuar edhe dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit të anesteziologut në kohëzgjatje prej 1 viti. Kurse, akuzat për “trafikim me njerëz” dhe “ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore”, ishin refuzuar. Anesteziologët Islam Bytyqi dhe Sulejman Dulla ishin shpallur fajtorë për veprën penale “lëndim i rëndë trupor” dhe ishin dënuar me burgim me kusht për një vit, ndërkaq ndaj tyre ishte refuzuar akuza për “ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore”.

Në fund, ish-sekretari permanent në Ministrinë e Shëndetësisë, Ilir Rrecaj ishte shpall i pafajshëm për “shpërdorim të pozitës zyrtare apo autorizimeve”, përderisa akuza për “falsifikim të dokumenteve zyrtare” ishte refuzuar. Ndërkaq, Driton Jilta i pati shpëtuar dënimin, pasi veprat për të cilat ai akuzohej “ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë njerëzore” dhe “shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimeve” ishte vjetërsuar.

Ndaj këtyre dy vendimeve, mbrojtësit e pesë të dënuarve dhe prokurori kishin paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit. Kjo e fundit, më 6 nëntor 2015 kishte shpallur aktgjykim, sipas të cilit

vërtetohen dënimet e të pandehurve dhe lirohet objekti i klinikës “Medicus” me arsyetimin se nuk ka bazë për konfiskim. Sipas aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit, përveç që dërgohen në burg tre të akuzuarit kryesor të këtij rasti, për dy prej tyre kishte rritur dënimet deri në dy vjet.

Arban Dervishi nga 7 vjet sa ishte dënuar nga shkalla e parë, dënohet me 8 vjet burgim, si dhe Sokol Hajdini nga 3 vjet sa ishte dënuar nga shkalla e parë vetëm për “lëndim të lehtë trupor”, dënohet me 5 vjet burgim, duke u shpallur fajtor edhe për “krim të organizuar”. Ndërkaq, dy të dënuarit me kusht nga shkalla e parë, Islam Bytyqi dhe Sulejman Dulla, ishin shpallur të pafajshëm nga shkalla e dytë.

Me një vendim të marrë më 26 maj 2016, Gjykata Supreme kishte hedhur ankesën e Lutfi Dervishit si të palejuar. Më 20 shtator 2016, Gjykata Supreme, duke vendosur sipas kërkesave të mbrojtësve të akuzuarve, e kishte kthyer në rigjykim rastin ndaj Lutfi Dervishit dhe Sokol Hajdinit, kurse ndaj të akuzuarve të tjerë ishin vërtetuar aktgjyqimet.

GjTh Prishtinë në maj të vitit 2018, Lutfi Dervishin e kishte shpallur fajtor për veprat penale, krim i organizuar dhe trafikim me qenie njerëzore dhe të njëjtin e kishte dënuar me shtatë vjet e gjashtë muaj burgim, si dhe 8.000 euro gjobë. Kurse, anesteziologun Sokol Hajdini e kishte dënuar me një vit burgim për veprën penale “lëndim i rëndë trupor”. Mjekut Dervishi, i ishte ndaluar edhe ushtrimi i profesionit të urologut prej dy vjetësh nga koha kur dënimi me burg është kryer, kurse në dënimin e shqiptuar, do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga 4 nëntori 2008 deri me 3 dhjetor 2008, si dhe 10 janar 2017 deri në ditën kur ky aktgjykim bëhet i formës së prerë.

Me 6 nëntor 2018, ishte mbajtur seanca në Gjykatën e Apelit ndërsa më pas Apeli e kishte anuluar aktgjykimin për të akuzuarin Dervishi, duke e kthyer lëndën në rigjykim, ndërsa për të akuzuarin Hajdini e ka refuzuar akuzën për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale.

Pas kthimit të rastit në rigjykim vetëm për të akuzuarin Lutfi Dervishi, procedura penale është bashkuar edhe me atë të djalit të tij, Arban Dervishi, për të cilin në gjykimin e mëparshëm ishte veçuar procedura ndaj tij, për shkak se ndodhej në arrati. Seanca e fundit në këtë rast ishte mbajtur më **27 tetor 2020**.

3. Rasti “Enver Sekiraqa”

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: PKR.nr.170/20

Ngritja e aktakuzës: 24.04.2014

Vepra penale: “*Shtytje në vrasje të rëndë*”

I akuzuari: Enver Sekiraqa

Faza e Procedurës: Rigjykim

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar 2,779 ditë apo 7 vite, 7 muaj e 8 ditë.

Në prill të vitit 2014, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kishte ngritur aktakuzë ndaj Enver Sekiraqes për tri vepra penale, për nxitje në vrasjen e Triumf Rizës, “detyrim” dhe “dhunim”, ku për këtë të fundit, gjykata e shkallës së parë e kishte shpallur të pafajshëm.

Prokuroria pretendon se incidenti i ndodhur në “Swiss Casino” në mes të Sekiraqës dhe Rizës ishte njëri nga motivet që çuan në vrasjen e Triumf Rizës. Incidenti në “Swiss Casino”, kishte ndodhur në dhjetorin e vitit 2006, ndërsa në të ishin të përfshirë Enver Sekiraqa dhe disa shoqërues të tij në njërën anë, dhe i ndjeri Triumf Riza e Arben Selmani në anën tjetër. Në këtë incident i plagosur rëndë kishte mbetur Arben Selmani. Triumf Riza u vra më 30 gusht të vitit 2007, vrasje për të cilën Arben Berisha është dënuar me 35 vjet burg, ndërsa Enver Sekiraqa me 37 vjet.

Ky rast aktualisht është duke u gjykuar për herë të tretë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Së pari, Sekiraqa me 17 maj 2016 nga Gjykata Themelore në Prishtinë ishte dënuar me dënim unik me 37 vite burgim për dy vepra penale për “nxitje në kryerje të vrasjes së rëndë” dhe për veprën “detyrimi” ndërsa ishte liruar për veprën penale “dhunimi”. Pas ankesës së mbrojtjes, ky rast ishte kthyer në rigjykim.

GjTh Prishtinë për herë të dytë më 16 shtator 2019, e kishte shpallur fajtor Enver Sekiraqën për nxitje në vrasjen e ish-policit Triumf Riza dhe i kishte shqiptuar dënim në kohëzgjatje prej 30 vitesh. Por, Gjykata e Apelit më 6 mars 2020 pas ankesës së mbrojtjes për të dytën herë e kishte kthyer këtë rast në rigjykim.

I akuzuari Sekiraqa aktualisht gjendet në masën e arrestit shtëpiak, por në paraburgim ai ka qëndruar për afro një dekadë, që nga 28 shtatori 2012, pas vetë dorëzimit të tij tek Policia e EULEX-it,.

4. Rasti “FAN”

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: PKR.nr.51/20

Ngritja e aktakuzës: 16.02.2016

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “mashtrimi” etj.

Të akuzuarit: Naser Osmani, Bahri Shabani, Shkelzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Adrian Kelmendi, Agim Deshishku

Faza e Procedurës: Rigjykim

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **2,116 ditë** apo **5 vite, 9 muaj e 16 ditë**.

Ky rast kundër Naser Osmanit e të tjerëve kishte filluar sipas kallëzimit penal të parashtruar nga Policia e Kosovës më 28 prill 2014. Prokuroria Speciale më 30 prill 2014, kishte marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, kurse kjo Prokurori më 16 shkurt 2016, kishte ngritur aktakuzë kundër ish-deputetit Naser Osmani, Bahri Shabani, Shkelzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Agron Kamberi, Adrian Kelmendi, të gjithë zyrtarë në AKP, si dhe Agim Deshishku, blerës i fabrikës “FAN”. Ndryshe, ndaj Agron Kamberit, tashmë është pushuar procedura, pasi ndaj tij prokuroria është tërhequr nga ndjekja penale.

Shqyrtimi kryesor në këtë rast kishte arritur të mbahet më 12 korrik 2017.

Sipas aktakuzës të akuzuarit Naser Osmani, si nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Bahri Shabani si drejtori i Bordit të AKP-së, Shkelzen Lluka si menaxher i AKP-së, Naim Avdiu si zv/drejtor menaxhues i AKP-së dhe Melita Ymeraga, Ardian Kelmendi, si kryesues të Njësisë së Monitorimit në AKP në bashkëpunim me zyrtarët e tjerë si anëtarë ndërkombëtarë të AKP-së: Lisa Brodey, Mohammed Omran dhe Hubert Ērsmann, i kanë kaluar kompetencat zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë për vete ose për personin tjetër, në vlerë prej 5,400,000,00 euro. Ata akuzohen se kanë shkelur të drejtat e punëtorëve të kësaj ndërmarrje, me çka njëkohësisht i kanë shkaktuar dëm Ndërmarrjes Shoqërore “FAN” e përfaqësuar nga AKP-ja si dhe buxhetit të shtetit, lidhur me çështjen e Ndërmarrjes së Re “FAN-Podujevë”.

Agim Deshishku, akuzohet nga prokuroria për mashtrim në vazhdimësi, legalizim i përmbajtjes së rreme në vazhdimësi dhe për shmangie nga tatimi

Më 8 shkurt 2019, Naser Osmani, Melita Ymeraga, Adrian Kelmendi, Bahri Shabani, Shkelzen Lluka dhe Naim Avniu ishin shpallur të pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë lidhur me privatizimin e fabrikës “FAN”. I pafajshëm për legalizim të përmbajtjes së rreme në vazhdimësi, ishte shpallur edhe i akuzuari Deshishku. Mirëpo, Deshishku ishte gjetur fajtor nga Gjykata Themelore në Prishtinë për veprën penale të mashtimit në vazhdimësi, për çka ishte dënuar me 1 vit burgim dhe se të njëjtit ky dënim i ishte vërtetuar edhe nga shkalla e dytë.

Pas ankesave nga PSRK-ja në shkallë të dytë, ky rast me 4 mars 2020 është kthyer në rigjykim dhe rigjykimi është tentuar të filloj më 8 korrik 202. Ky rast është i shënjestruar për liberalizim

të vizave dhe kishte qenë duke u gjykuar nga gjykatësi Shashivar Hoti. Mirëpo, pasi i njëjti kishte ndërruar jetë në korrik të vitit 2020, ky rast i është trashëguar gjykatësit Agim Kuçi.

Pas kthimit të rastit në rigjykim, gjykata e shkallës së parë kishte filluar ta trajtojë këtë lëndë vetëm pasi kishte kaluar afro **një vit e gjysmë**. Lidhur me këtë, katër seancat e caktuara, ajo e 8 korrikut, 28 shtatorit, 28 tetorit dhe 25 nëntorit 2021 kishin dështuar të mbaheshin, për shkak të mungesës së palëve në procedurë. Ky rast në janar të vitit 2022 arrin parashkrimin absolut të ndjekjes penale.

5. Rasti “Aktivistat”

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: PKR.nr.70/18

Ngritja e aktakuzës: 28.12.2016

Vepra penale: “terrorizëm”

Të akuzuarit: Frashër Krasniqi, Atdhe Arifi, Egzon Haliti dhe Adea Batusha

Faza e Procedurës: Rigjykim

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **1,800 ditë apo 4 vite, 11 muaj e 4 ditë**.

PSRK-ja në dhjetor të vitit 2016, kishte ngritur aktakuzë kundër, Frashër Krasniqit, Atdhe Arifit, Egzon Halitit dhe Adea Batushës, të cilët i akuzon për kryerjen e veprës penale të terrorizmit.

Ndaj katër aktivistëve të Vetëvendosjes, PSRK-ja ka ngritur aktakuzë, katër muaj pasi të njëjtit, bashkë me tani të ndjerin Astrit Dehari, u arrestuan si të dyshuar për sulmin e 4 gushtit 2016, ndaj objektit të Kuvendi të Kosovës, por që Dehari kishte vdekur në nëntor të vitit 2016 në qelinë e tij në qendrën e paraburgimit në Prizren. Sipas aktakuzës, të pandehurit kanë vepruar si grup i organizuar “me qëllim që të shkaktojnë frikësimin serioz të popullsisë dhe shkaktimin e ndjenjës se pasigurisë për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës”.

Ky rast është duke u trajtuar për herë të dytë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Fillimisht, kjo gjykatë më 27 nëntor të vitit 2017, kishte shpallur fajtorë katër të akuzuarit, duke i dënuar me 21 vjet e gjashtë muaj burgim. Ish-deputeti Frashër Krasniqi ishte dënuar me 8 vjet burgim, Atdhe Arifi ishte dënuar me 6 vjet burgim, Egzon Haliti me 5 vjet e gjysmë si dhe Adea Batusha me 2 vjet heqje lirie.

Pas ankesave, Gjykata e Apelit më 27 shkurt 2018 lëndën e kishte kthyer në rigjykim. E që pas rigjykimit, para trupit gjykues të udhëhequr nga gjykatësi Kalludra, ishin caktuar gjithsej gjashtë seanca, prej të cilave vetëm tri kishin arritur të mbahen.

Këtë rast, fillimisht e kishte gjykuar gjykatësi Beqir Kalludra, por pas avancimit të tij në Gjykatën e Apelit me vendimin e 21 dhjetorit 2020, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK),

lënda ka kaluar tek gjykatësi Kushtrim Shyti, e më pas përfundimisht këtë lëndë do ta gjykojë gjykatësi i Departamentit Special, Vesel Ismaili.

Seanca e radhës në këtë rast pritet të mbahet më 7 dhjetor 2021, **kur kanë kaluar pothuajse një vit** nga hera e fundit kur ky gjykim ishte tentuar pa sukses që të mbahej.

6. Rasti “Toka”

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: PKR.nr.610/16

Ngritja e aktakuzës: 24.10.2016

Vepra penale: “*krim i organizuar*”, “*pastrim i parave*”, “*marrje të mitos*”, “*mashttrim në detyrë*” etj.

Të akuzuarit: Azem Syla etj.

Faza e Procedurës: Në proces.

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **1,865 ditë** apo **5 vite, 1 muaj e 8 ditë**.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), kishte ngritur dy aktakuza, njëra me 17 persona dhe tjetra me 22 persona, ku në këtë të fundit, që ishte ngritur më 24 tetor 2016 përfshihet edhe ish-deputeti i PDK-së Azem Syla, që sipas PSRK-së, ai kishte qenë edhe udhëheqës i këtij grupi. Bashkë me Sylën, në këtë proces janë duke u gjykuar edhe Shaban Syla, Arton Vila, Fahredin Gashi, Shpresim Uka, Ramadan Uka, Avdurrahman Brajshori, Gazmend Gashi, Lubisha Vujoviq, Sabedin Haxhiu, Avni Maxhuni, Elhame Uka, Lumnije Sopjani, Nyrtenë Brajshori, Sami Maqedonci, Ndue Palushi, Ramadan Mavraj.

Pjesë e kësaj aktakuze kanë qenë edhe Nuhi Uka, Shqipe Maxhuni, Ilaz Syla, Mustafë Haliti dhe Hajrullah Berisha, por për dy të parët është pushuar procedura pasi ata kanë ndërruar jetë, ndërsa për shkak se gjykata nuk ka arritur të siguroi prezencën e Ilaz Sylës, Mustafë Halitit dhe Hajrullah Berishës, për të njejtit është vecuar procedura.

Aktakuza i ngarkon të pandehurit me vepra penale “*krim i organizuar*”, “*pastrim i parave*”, “*marrje të mitos*”, “*mashttrim i rëndë*”, “*mashttrim në detyrë*”, “*nxjerrje të vendimeve gjyqësore të kundërligjshme*”, “*keqpërdorim i pozitës zyrtare*”, “*legalizimi i përmbajtjes së falsifikuar*” dhe “*evazion fiskal*”. Gjithashtu, të pandehurit akuzohen se në bashkëpunim, përmes veprimtarive kriminale i kanë privuar Kosovës pronat shoqërore, duke përfshirë falsifikimin e vendimeve dhe dokumenteve zyrtare, mashttrim dhe veprime tjera korruptive.

Ndryshe, kjo lëndë fillimisht gjykohej nga gjykatësi Beqir Kalludra dhe pasi që gjykimi ishte afër përfundimit të tij, avancimi i gjyqtarit Kalludra në Apel kishte ndikuar që kjo lëndë të mbetej pa u përfunduar.

Duke u bazuar në Kodin e Procedurës Penale, të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve, të akuzuarve dhe provave të tjera që janë shqyrtuar nga gjykatësi Kalludra, duhet që të shqyrtohen edhe njëherë nga fillimi nga kryetari i ri i trupit gjykues, Arben Hoti.

Gjykata Themelore në Prishtinë këtë lëndë më pas ia kishte ndarë në punë gjykatëses Shpresa Hasaj Hyseni, e cila nuk kishte mbajtur asnjë seancë. Ndërsa aktualisht ky rast i është ndarë në punë gjykatësit të Departamentit Special të GjTh në Prishtinë Arben Hoti.

Ndryshe, ky shqyrtim nga fillimi i gjykimit është karakterizuar me zvarritje, në masën më të madhe, në kohën që gjykohej nga gjykatësit e EULEX-it. Më 12,13 dhe 15 dhjetor të vitit 2016, ishte mbajtur seanca fillestare, në të cilin të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.

Kryetari i atëhershëm i trupit gjykues, gjykatësi Arkadiusz Sedeck, më 4 prill 2017 kishte konfirmuar aktakuzën, ndërsa pas ankesave në Gjykatën e Apelit, shkalla e dytë e kishte konfirmuar aktakuzën më 26 tetor 2017. Sedeck, fillimin e shqyrtimit gjyqësor e kishte caktuar, pas më shumë se një viti nga vendimi i Apelit, më 9 janar 2018, por e njëjta kishte dështuar për shkak të mosplotësimit të trupit gjykues. Edhe pse kishte caktuar shumë seanca të tjera, gjyqtarët e EULEX-it nuk kishin mundur që të fillojnë këtë shqyrtim, pasi EULEX-i hoqi dorë nga ky rast dhe lënda kaloi të gjyqtari vendor Beqir Kalludra.

Ndërsa, pas disa dështimesh për mbajtje të seancës, seanca e parë e këtij shqyrtimi ishte mbajtur më 3 shtator 2018, ndërsa fjala hyrëse në këtë rast ishte dhënë në seancën e 25 qershorit 2019.

Seanca e fundit në këtë rast ishte tentuar të mbahej më **18 qershor 2020**.

7. Rasti Ukë Rugova

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: PKR.nr.305/16

Ngritja e aktakuzës: 18.05.2016

Vepra penale: “Krim i organizuar”, “kontrabandimi me migrantë”, “armëmbajtje pa leje”.

Të akuzuarit: **Ukë Rugova etj.**
Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 15 dhjetor 2021 kanë kaluar **2,024 ditë** apo **5 vite,**
6 muaj e 14 ditë.

Faza e Procedurës: Në proces.

Aktakuza e (PSRK), e ngritur më 16 maj të vitit 2016, e ngarkon Ukë Rugovën se gjatë periudhës maj 2011 deri në shkurt 2014 ka menaxhuar një grupi kriminal duke furnizuar individë me viza shengen të BE-së, nga Ambasada Italiane në Prishtinë. Të gjitha këto viza supozohet se janë marrë në mënyrë të paligjshme nëpërmjet shtrembërimit apo korrupsionit. Ai akuzohet edhe për veprën penale posedim i pa autorizuar i armëve ku në rezidencën e tij i ishin gjetur një pistoletë dhe dy karikator.

Aktakuza që ishte përpiluar nga prokurori Allen Cansick, thekson se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka pranuar nga Prokuroria Italiane në Romë një kopje të dosjes së tyre lidhur me vizat ku përfshihet edhe emri i ish-ambasadorit Italian në Kosovë Michael Giffoni.

Bashkë me Ukë Rugovën në këtë rast janë të akuzuar edhe Izet Beqiri, Florjan Petani, Qefser Baholli, Astrit Haraqija, Fitim Beqiri, Azad Beqiraj, Liridona Beqiri, Kujtim Avdyli, Ragip Gashi, Visar Beqiri Hamza Beqiri, Azem Koskoviku, Edison Idrizaj, Beg Shaqiri, Hasan Shaqiri, Dritëro Voca, Valon Selimi, Fadil Ahmeti dhe Haxhi Islami. Prokuroria pretendon se ky grup, siç e cilëson kriminal, kishte për qëllim sigurimin e përfitimit material në atë mënyrë që qytetarët të pajisen me viza shengen nga Ambasada Italiane në Prishtinë.

Ky rast tashmë është ndarë në dy pjesë pasi siç kishte thënë gjykatësja Naime Krasniqi-Jashanica, një gjë e tillë është bërë në mënyrë që gjykim të jetë më efikas. Ukë Rugova, Astrit Haraqija, si dhe Florjan Petani, Qefser Baholli dhe Izet Beqiri janë duke u gjykuar veçmas nga 15 të akuzuarit tjerë.

Ndryshe, ky rast gjykohej nga misioni i EULEX-it, por pas përfundimit të mandatit, lënda ishte transferuar të vendorët. Kjo lëndë, më pas ishte caktuar te gjykatësja Naime Krasniqi-Jashanica, e cila nuk kishte caktuar asnjë seancë në vitin 2018, me arsyen që ky rast nuk ishte prioritet për gjykatën.

Pas kalimit të gjykatës Krasniqi-Jashanica në Departament të Përgjithshëm, për këtë rast ishte caktuar gjykatësja Fatime Dermaku, duke bërë që ky gjykim të filloj rishtazi. Paraprakisht, seanca e fundit e mbajtur në këtë rast ishte ajo e 14 janarit 2020.

8. Rasti “KIKI”

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: PKR.nr.468/09

Ngritja e aktakuzës: 12.11.2009

Vepra penale: “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”

E akuzuara: Zylahaje Abdullahu.

Faza e Procedurës: Në proces.

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **2,024 ditë apo 12 vite e 20 ditë.**

Aktakuza ndaj të pandehurës Abdullahu ishte ngritur më 12 nëntor 2009 nga prokurori i Eulexit, Jari Mikko Auvinen, ku tani aktakuza përfaqësohet nga prokurorja e krimeve të rënda e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Bukurije Gjonbalaj. Abdullahu akuzohej se më 17 mars 2004 në Fushë Kosovë ka marrë pjesë me një veprim kolektiv, ka kryer zjarr vënie dhe në këtë mënyrë ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm dhe në masë të madhe ka dëmtuar pronën e të dëmtuarës, Dobrinka Stankoviç. Sipas aktakuzës, ajo kishte hyrë në shtëpinë e saj, ishte ngjitur në kulmin e shtëpisë, kishte filluar t’i heq tjegulla dhe ia kishte vënë zjarrin shtëpisë duke gjuajtur rroba të djegur brenda shtëpisë, brenda së cilës gjendej vajza dhe djali i saj. Për këtë,

Abdullahu akuzohej se ka kryer veprën penale “Pjesëmarrje në turmën që kryen veprën penale nga neni 320, paragrafi 1 dhe Neni 23 të KPK-së.

Vepra penale “Pjesëmarrje në turmën që kryen veprën penale” nga neni 320 dhe “nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik” janë parashkruar, kështu që e akuzuara Abdullahu tani po akuzohet vetëm për veprën penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm.

Tentativa e fundit nga gjykata për mbajtjen e kësaj seance ishte ajo e 12 majit 2021, por e cila kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së të akuzuarës.

9. Rasti Granit Elshani

Gjykata Themelore Gjakovë

Nr. i lëndës: PKR.nr.191/20

Ngritja e aktakuzës: 25.11.2016

Vepra penale: “Vrasje e rëndë”, etj.

I akuzuari: Granit Elshani

Faza e Procedurës: Rigjykim.

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **1833 ditë apo 5 vite e 7 ditë**.

Sipas aktakuzës së PSRK-ës të ngritur më 25 nëntor 2016, më 2 janar të vitit 2010, në diskotekën “City Club” në Pejë i akuzuari Elshani, kishte hyrë me dy revole të tipit “TT” dhe kishte filluar të shtinte në drejtim të tani të ndjerit Besart Shabi dhe Valdet Kelmendit, i cili ishte plagosur. Siç përshkruhet në aktakuzë, natën kritike Elshani shënjestër të vrasjes kishte anëtarin e familjes Kelmendi, Valdetin, por që plumbi kishte goditur Besart Shabi, i cili kishte qëlluar afër tij. Sipas prokurorit, atë natë lëndime kishin pësuar edhe persona të tjerë që ishin mbledhur për të festuar, ndër ta edhe zyrtari policor, Hasan Buqaj.

Lidhur me këtë rast, GjTh në Pejë, më 30 maj të vitit 2018, ka shqiptuar 25 vjet burgim ndaj Granit Elshanit për veprat penale “vrasje e rëndë”, “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”, “vrasje e rëndë në tentativë” dhe “mbajte në pronësi, posedim dhe përdorim të paautorizuar të armëve”.

Gjykata e Apelit me vendimin e nxjerrë më 11 dhjetor 2018 kishte anuluar aktgjykimin në fjalë, duke miratuar ankesën e mbrojtjes. Pas kthimit të rastit në shkallë të parë, rigjykimi në këtë rast në Gjykatën e Pejës kishte zgjatur rreth 1 vit e 7 muaj, deri në ditën kur ishte caktuar të bëhej shpallja e aktgjykimit, mirëpo kjo nuk kishte ndodhur pasi që trupi gjykues i kryesuar nga ish-gjykatësi Sylë Lokaj, i cili ka dalë në pension, kishte vendosur që të rihapej shqyrtimi gjyqësor për këtë rast.

Në tetor të vitit 2020 ky rast ishte transferuar në GjTh në Gjakovë me kërkesën e kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, Armend Berisha, për shkak të mungesës së gjyqtarëve të krimeve të rënda dhe gjyqtarëve tjerë të cilët kanë mbetur, kanë bazë për përjashtim në gjykimin e këtij rasti.

Pas këtij transferimi, më 23 nëntor 2020 ka nisur nga fillimi rigjykimi ndaj të akuzuarit, Granit Elshani.

10. Rasti Shaip Ferizi

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: PKR.nr.38/2020

Ngritja e aktakuzës: 30.12.2008

Vepra penale: “Krim i organizuar.”, “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” etj.

Të akuzuar: Shaip Ferizi etj.

Faza e Procedurës: Rigjykim

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **4720 ditë** apo **12 vite, 11 muaj e 2 ditë**.

Sipas aktakuzës së ngritur më 30 dhjetor 2008, nëntë të akuzuarit që nga 8 shtatori 2006 e deri më 9 tetor 2007, kishin kryer krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal, duke e pasur secili rolin e tyre të ndarë në veprimtari kriminale. Në aktakuzë thuhet se gjatë importimit të cigareve si kontraktues të KFOR-it dhe në emër të KFOR-it kishin keqpërdorur detyrat zyrtare. Sipas aktakuzës, cigaret në vlerë prej 2 milionë e 931 mijë e 929 euro nuk i kishin dorëzuar në KFOR, por u kanë shitur kompanive të tjera pa banderolë, duke shkaktuar evazion fiskal ndaj buxhetit të konsoliduar të Kosovës në shumë prej 2 milionë e 441 mijë 927 euro.

Prokuroria të akuzuarit Shaip Ferizi, Shqipe Avdiu dhe Arben Jashari, i ngarkonte me veprat penale “krim i organizuar”, lidhur me veprën penale “shpërdorim i detyrës zyrtare” si dhe me veprën penale “shmangie mashtruese nga pagesat e detyrimeve”. Ndërsa, të pandehurit Mustafë Vitia, Mexhid Mustafa, Lulzim Gashi, Besnik Ferizi, Faton Topanica, Arsim Topanica dhe Ajdar Jashari, i ngarkonte me veprën penale “krim i organizuar” lidhur me veprën penale “shmangie nga pagesat e detyrimeve”.

Më 11 mars 2019, GjTh në Prishtinë, kishte dënuar me burgim me kusht nëntë të akuzuarit për krim të organizuar Shaip Ferizin, Shqipe Avdiun, Arben Jasharin, Mustafë Vitinë, Mexhid Mustafën, Besnik Ferizin, Faton dhe Arsim Topanicën si dhe Ajdar Jasharin. Mirëpo ky vendim ishte anuluar nga Gjykata e Apelit më 18 dhjetor 2019, e cila këtë rast e kishte kthyer në rigjykim.

Kjo lëndë fillimisht është gjykuar nga gjykatësja Shadije Gërguri por pas kthimit të rastit në rigjykim, lënda i është ndarë në punë gjykatësit Naser Foniqi, meqenëse gjykatësja Gërguri ka kaluar në Departamentin Special. Së fundmi, kjo lëndë sërish ka kaluar tek gjykatësja Gërguri,

sipas një vendimi të Kryetares së gjykatës që gjykatësit e Dep. Special të ngarkohen edhe me lëndë të DKR-së. Që nga kthimi i këtij rasti në rigjykim, gjykata e shkallës së parë ende nuk ka caktuar seancë për të proceduar tutje me këtë lëndë, edhe kur kanë kaluar afërsisht **dy vite**.

11. Rasti Naser Pajazitaj

Gjykata Themelore Ferizaj

Nr. i lëndës: PKR.nr.9/20

Ngritja e aktakuzës: 08.06.2017

Vepra penale: “Vrasje e rëndë” etj.

I akuzuari: Naser Pajazitaj

Faza e Procedurës: Rigjykim.

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **1638 ditë** apo **4 vite, 5 muaj e 24 ditë**.

Aktakuza e ngritur më 8 qershor 2017 nga PTh në Pejë, ku Naser Pajazitaj po akuzohet se më 9 nëntor 2015, në bjeshkët e Strellicit, Komuna Deçanit, e pikërisht në vendin e quajtur të “Kroni i Lajthisë“, i pandehuri edhe pse më parë ka qenë i dënuar për vrasje, me dashje dhe me armë dhe atë revole të tipit të panjohur në mënyrë mizore e ka privuar nga jeta viktimën Donjeta Pajazitaj nga po i njëjti fshat.

Fillimisht, Gjykata Themelore në Pejë, në mars të vitit 2018, të akuzuarin Naser Pajazitaj, në mungesë të provave e kishte liruar nga akuzat, por pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Apelit e kishte kthyer këtë lëndë në rigjykim.

Pas kthimit në rigjykim, Gjykata Themelore në Pejë, në mars të vitit 2019, e kishte dënuar me burgim të përjetshëm. Ky dënim ishte vërtetuar pastaj edhe nga Gjykata e Apelit në korrik të vitit 2019. Por, në nëntor të vitit 2019, Gjykata Supreme i kishte prishur të dy aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Pejë dhe të Gjykatës së Apelit dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim.

Pas kthimit të rastit në rigjykim, Gjykata Themelore në Pejë ishte përjashtuar nga ky rast dhe lënda ishte deleguar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me arsyetimin për të mënjanuar dyshimet ndaj sistemit të drejtësisë. Vendimi për delegimin e lëndës në Ferizaj ishte marrë nga Gjykata e Apelit.

Për herë të tretë, GjTh e Ferizaj më 27 maj 2021 e kishte dënuar me burgim të përjetshëm Naser Pajazitajn. Por edhe ky vendim është anuluar nga Apeli, e cila më 29 tetor 2021 këtë çështje e ka kthyer sërish në rigjykim tek GjTh e Ferizaj, duke bërë që për këtë çështje penale të procedohet për herë të katër.

Kjo larmi e vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta dhe kthimi i shpeshtë i këtij rasti në rigjykim nga Apeli, i ka kontribuar zvarritjes së kësaj çështje penale, duke rënduar edhe më shumë pozitën e pjesëmarrësve proceduralë.

12. Rasti “Trafikimi”

Gjykata Themelore Gjilan

Nr. i lëndës: PKR.nr.19/2007

Ngritja e aktakuzës: 14.02.2006

Vepra penale: “Trafikimi me njerëz”

Të akuzuar: Muhamet Dobratiqi, Demir Hasani, Daut Azizi

Faza e Procedurës: Rigjykim.

Në këtë rast nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **5770 ditë** apo **15 vite, 9 muaj e 18 ditë**.

Sipas aktakuzës, në janar të 2006-ës, në Viti, në bashkëveprim i pandehuri D.H dhe D.A, kanë kërkuar nga i pandehuri M.D, që i njëjti t’ua sigurojë një punëto, me qëllim që të punojë në lokalit e të pandehurit D.H. I pandehuri i parë në shoqëri me pronarin e lokalit dhe me automjet me të pandehurin D.A, kanë shkuar në shtëpinë ku është duke jetuar nëna e të pandehurit të parë, me qëllim që ta marrin numrin e telefonit të dëmtuarës S.S. dhe pasi që kanë marrë informata se ku është duke punuar ajo, si kundërshtëpërblim, i pandehuri i parë dhe i dytë, kanë marrë nga 50 euro dhe kanë shkuar në vendin e punës, duke e ftuar për pije. Në aktakuzë thuhet se përkundër dëshirës së të dëmtuarës, ata e kanë dërguar të njëjtën në lokalit e të pandehurit D.H. dhe pastaj ky i fundit bashkë me D.A, e kanë shitur të dëmtuarën te klientë të ndryshëm dhe në emër të marrëdhënieve seksuale që ka pasur e dëmtuara me ata, të pandehurit kanë marrë të holla.

Ish-Gjykata e Qarkut në Gjilan më 4 korrik 2006 kishte gjetur fajtor të akuzuarit Dobratiqi dhe Hasani, ashtu që ndaj Dobratiqit kishte shqiptuar 8 muaj burgim, ndërsa ndaj Hasanit 6 muaj burgim. I pafajshëm ishte shpallur i akuzuari i tretë Daut Azizi.

Gjykata Supreme duke vendosur për ankesën e ushtruar nga ish-Prokurori Publik i Qarkut në Gjilan, më 9 janar 2007 kishte anuluar vendimin e shkallës së parë dhe këtë lëndë e kishte kthyer në rigjykim.

Që nga kthimi i këtij rasti në rigjykim, kjo lëndë akoma nuk ka marrë epilog final. Aktualisht procedura është duke vazhduar edhe kur kanë kaluar 16 vite nga ngjarja kritike. Ndaj të akuzuarit Azizi është bërë veçimi i procedurës dhe është lëshuar letërrreshtimi, ashtu që aktualisht gjykimi po vazhdon ndaj Dobratiqit dhe Hasanit.

ANEX 2. Rastet DP

1. Rasti Agim Ademi

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.1761/21

Ngritja e aktakuzës: 14.01.2014

Vepra penale: “Detyrimi

I akuzuar: Agim Ademi etj.

Faza e Procedurës: Rigjykim

Nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **2879 ditë** apo **7 vite, 10 muaj e 18 ditë**.

Sipas pikës së parë të aktakuzës, Ademi dhe Rama akuzohen se gjatë periudhës kohore 12 korrik – 12 shtator 2012, me qëllim të përfitimit material e kishin kërcënuar dhe sulmuar viktimën Dritëro Kadollin, duke e detyruar të njëjtin të bëjë veprime në dëm të pasurisë së tij, respektivisht të bëjnë përfitim të pa drejtë në shumën prej 30,000.00 euro, apo një veturë të tipit “BMË X5”. Ndërkaq, në pikën e dytë të aktakuzës të pandehurit Ademi dhe Rama akuzoheshin për ushtrim të ndikimit në bashkëkryerje, mirëpo për këtë vepër penale ishte shpallur aktgjykim refuzues për shkak se kjo vepër penale është parashkruar.

Ndryshe, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 5 korrik 2019, Ademin e kishte dënuar me 9 muaj burgim efektiv për “detyrim në tentativë”, ndërsa Ramën me një vit burg efektiv. Mirëpo në shkurt të vitit 2020, Gjykata e Apelit i kishte refuzuar ankesat e të akuzuarve të ushtruara nga aktgjykimit të shkallës së parë, duke i lënë në fuqi dënimet e shqiptuara nga shkalla e parë.

Ndërkaq, Gjykata Supreme në gusht të vitit 2020 e ka kthyer në rigjykim në shkallën e parë këtë rast. Shtatë muaj pas kthimit të këtij rasti në rigjykim, GjTh në Prishtinë më 24 mars 2021 kishte provuar por pa sukses që të nis rigjykimin ndaj Ademit dhe të akuzuarit tjetër.

Pas rigjykimit kjo lëndë fillimisht nisi të gjykohej në Departamentin për Krime të Rënda, mirëpo më pas, e njëjta ishte deleguar në Departamentin e Përgjithshëm të kësaj gjykate, si pasojë e parashkrimit të veprës penale të ushtrimit të ndikimit. Në kuadër të këtij departamenti, ishte tentuar më 4 tetor të nis rigjykimi, por pa sukses, për shkak të mungesës së të dëmtuarit.

2. Rasti Mytaher Haskuka

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: PKR.nr.233/2016

Ngritja e aktakuzës: 15.04.2016

Vepra penale: “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, “pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”

Të akuzuar: Mytaher Haskuka, Rexhep Selimi etj.

Faza e Procedurës: Në proces

Nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar 2057 ditë apo 5 vite, 7 muaj e 17 ditë.

Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë me 15 prill 2016 ndaj të akuzuarve Enver Hoti, Shqipte Pantina, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu dhe Rexhep Selimi, pasi të njëjtit akuzohen se më 19 shkurt 2016, gjatë seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, pa autorizim kanë hedhur gazin lotsjellës me qëllim të ndërprerjes së punimeve të seancës. Me këtë, Hoti, Pantina, Haskuka, Haxhiu dhe Selimi secili veç e veç po akuzohen se kanë kryer veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 375, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas dispozitivit të dytë të kësaj akuze, në kohë, vend dhe mënyrë si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, të akuzuarit Hoti, Pantina, Haskuka, Haxhiu dhe Selimi po akuzohen se kanë penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare – deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës , në atë mënyrë që posa ka filluar seanca e kuvendit, pas aktivizimit të gazit lotsjellës është ndërprerë seanca plenare. Ky rast akoma nuk është trajtuar nga gjykata, që nga ngritja e kësaj aktakuze.

3. Rasti “Avni Mazreku”

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.2092/20

Ngritja e aktakuzës: 26.04.2016

Vepra penale: “Legalizimi i përmbajtjes së rreme”

I akuzuar: Avni Mazreku

Faza e Procedurës: Rigjykim

Nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar 2046 ditë apo 5 vite, 7 muaj e 6 ditë.

PTh në Prishtinë, më 26 prill 2016 kishte ngritur aktakuzë ndaj Avni Mazreku për veprën penale “legalizim i përmbajtjes së rreme”. Mazreku akuzohet se 30 qershor 2014, në Agjencinë e Kosovës për Akreditim në Prishtinë, e ka vënë në lajthim organin kompetent që në një dokument publik, libër apo regjistër, të vërtetojë një çështje të pavërtetë të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore. Mazreku thuhet se përmes sekretarit të kolegjit “ISPE”,

Veton Sahiti ia kishte dorëzuar konfirmimin e pagesës të printuar përmes sistemit elektronik “E-Banking” nga llogaria e këtij kolegji në “Raiffeisen Bank”, kinse e ka të kryer pagesën e mbetur në shumë prej 19.500 euro. Si rezultat i kësaj pagese, siç thuhet në aktakuzë, aplikacioni i kolegjit “ISPE” ishte futur në shqyrtim në mbledhjen e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, e cila ishte mbajtur më 1 korrik 2014.

Gjykimi ndaj Mazrekut kishte filluar më 19 mars 2018, pothuajse dy vite pas ngritjes së aktakuzës. Lidhur me këto akuza, ai më 3 prill 2019 ishte shpallur fajtorë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me burgim në kohëzgjatje prej tre vite. Por, më pas këtë lëndë Gjykata e Apelit e kishte kthyer në rigjykim më 16 korrik 2020.

Ndryshe, ky rast ishte gjykuar më parë nga gjykatësja Fatime Dermaku, por pasi e njëjta ka kaluar në Departamentin për Krime të Rënda, pas kthimit të rastit në rigjykim, kjo lëndë i është ndarë në punë gjykatësit Sabit Sadikaj. Gjykatësi Sadikaj kishte filluar ta trajtojë këtë rast në janar 2021. Seanca e radhës do të mbahet më 13 dhjetor, apo afër një viti nga ajo e fundit.

4. Rasti Gazmend Muhaxheri

Gjykata Themelore Pejë

Nr. i lëndës: P.nr.493/17

Ngritja e aktakuzës: 03.05.2017

Vepra penale: “Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore”

I akuzuar: Gazmend Muhaxheri

Faza e Procedurës: Aktgjykim nga Gjykata Supreme

Nga ngritja e aktakuzës e deri vendimin e shkallës së tretë kanë kaluar **1323 ditë** apo **3 vite, 7 muaj e 13 ditë**.

PTh në Pejë më 3 maj 2017 kishte ngritur aktakuzë ndaj Gazmend Muhaxherit të cilin e akuzonte se më 24 mars 2016, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Pejës, ka refuzuar të ekzekutojë vendimin e plotfuqishëm të Gjykatës së Apelit të Kosovës, për të kthyer Hysni Selmanaj në vendin e punës si drejtor i Auditorit të Brendshëm.

Seanca fillestare ishte mbajtur më 27 dhjetor 2018, apo 604 ditë pas dorëzimit të aktit akuzues në gjykatë. Mirëpo, GjTh në Pejë, nuk ishte mjaftuar me vetëm një shqyrtim fillestar ndaj Kryetarit të Pejës, Muhaxheri. Kjo gjykatë, kishte caktuar shqyrtimin fillestar për herë të dytë më 24 qershor 2019, ku sërish Muhaxheri ishte deklaruar i pafajshëm.

Ky proces gjyqësor ishte përcjellë me zvarritje të shumta, ngase i akuzuari Muhaxheri nuk iu ishte bindur thirrjeve të gjykatës, duke bërë që të dështonin tri seanca të caktuara, ndërsa urdhri për sjellje të detyrueshme ishte marrë pas këtyre dështimeve të njëpasnjëshme.

Kjo gjykatë më 19 gusht 2019 e kishte hedhur poshtë aktakuzën ndaj Muhaxherit për këtë veprë penale. Ky vendim në shkallë të parë ishte vërtetuar edhe nga Apeli më datë 21 nëntor 2019, dhe nga Supremja më 15 dhjetor 2020.

Në këtë rast organin e akuzës e kishin përfaqësuar katër prokurorë të ndryshëm.

5. Rasti Naser Azemi

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.194/14

Ngritja e aktakuzës: 12.05.2010

Vepra penale: “rrezikimi i trafikut publik”

I akuzuar: Naser Azemi

Faza e Procedurës: Aktgjykim në shkallë të dytë

Nga ngritja e aktakuzës e deri vendimin e shkallës së dytë kanë kaluar **3537 ditë** apo **9 vite, 8 muaj e 5 ditë**.

Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, më 12 maj 2010, kishte ngritur aktakuzë ndaj Naser Azemit, të cilin e akuzonte se më 30 prill 2009, në rrugën “Nazim Gafurri”, në Prishtinë, ka shkelur Ligjin mbi Trafikun Publik dhe ka rrezikuar atë dhe jetën e njerëzve. Pasi i akuzuari ishte kyçur me automjetin e tij transportues, në rrugën kryesore, e cila të çon në drejtimin e Gërmisë, me një shpejtësi para aksidentit rreth 5 km/h, dhe pasi që kishte arritur afër kafenesë “Andora”, duke mos iu përshtatur shpejtësisë së lëvizjes së automjetit, kushteve në rrugë, gjegjësisht duke mos i kushtuar kujdesin e duhur pjesëtarëve të tjerë në komunikacion, me pjesën e parë të anës së majtë të automjetit, fëmijën A.J, me ç’rast pas goditjes me kamion asaj i ishin shkaktuar asaj lëndime vdekjeprurëse, e cila më pastaj edhe përkundër tretmanit mjekësor, kishte ndërruar jetë në QKUK në Prishtinë.

GjTh në Prishtinë më 14 maj 2019 e kishte dënuar me dy vjet burgim efektiv Ademin. Deri në nxjerrjen e vendimit në shkallë të parë që nga ngritja e aktit akuzues kishin kaluar 3290 ditë, apo plot nëntë vite.

Gjykata e Apelit me vendimin e saj të nxjerrë më 16 janar 2020 e kishte ndryshuar këtë vendim sa i përket lartësisë së dënimit, duke e zbritur në një vit e tetë muaj burgim.

6. Rasti Fitim Gjata

Gjykata Themelore Pejë

Nr. i lëndës: P.nr.79/14

Ngritja e aktakuzës: 07.07.2014

Vepra penale: “*Shmangie mashtruese nga Taksa e Importit dhe Akciza*”

I akuzuar: Fitim Gjata

Faza e Procedurës: Hudhje e aktakuzës

Nga ngritja e aktakuzës e deri në vendimin e shkallës së dytë kanë kaluar **2473 ditë** apo **6 vite, 9 muaj e 7 ditë**.

Sipas aktakuzës së 7 korrikut 2014, Fitim Gjata akuzohej se gjatë periudhës kohore 2007-2011 në pikën Doganore në Kullë në Pejë, pikërisht te zyrtarët doganorë, ka dorëzuar dokumente që janë të pavërteta. Ai si pronar i biznesit NTP “Daja”, me seli në Prishtinë, përgjatë importimit të mallrave nga shtetet e jashtme, kishte bërë nënvlerësim të mallit dhe në disa raste ka fshehur origjinën e vërtetë të mallit ku ka paraqitur dokumente të pavërteta. Sipas aktakuzës kjo ishte konstatuar pas verifikimit të transfereve bankare dhe xhirologarinë e subjektit afarist të tij ku ka rezultuar me importe të realizuara në shumë prej 5 milionë e 555 mijë e 602 euro e 74 centë.

Derisa, nga llogaria e tij, në aktakuzë thuhej se janë paguar jashtë vendit në emër të blerjes së mallrave, shuma prej 6 milionë e 979 mijë e 389 euro e 27 centë. Tutje, sipas aktakuzës se i njëjti kishte importuar mallra nga Kina, e në të vërtetë ato i ka paraqitur si mallra të importuara nga Zvicra. Kjo aktakuzë e Prokurorisë së Pejës, është refuzuar nga gjykatësja e rastit, Florije Zatriqi më 13 prill 2021, pasi prokurori Dorian Juniku kishte hequr dorë nga aktakuza, për shkak të vjetërsimit të veprës penale.

Sipas shkresave të siguruara nga “Betimi për Drejtësi”, rezulton se më 18 prill 2013, Dogana e Kosovës, kishte parashtruar kallëzim penal në prokurori, ndërsa kjo e fundit, hetimet i kishte nisur më 24 mars 2014, apo mbi 11 muaj pas parashtrimit të kallëzimit penal. Që nga ngritja e aktakuzës, ishin mbajtur vetëm katër seanca gjyqësore, ndërsa seanca e parë fillestare në këtë rast, ishte mbajtur më 17 prill 2019, respektivisht pas mbi 4 vite e 9 muaj pas ngritjes së aktakuzës.

Ende pa u mbajtur shqyrtimi fillestar, ishte bërë parashkrimi absolut i njëres pikë të aktakuzës për veprën penale të dhënies së deklaratës së pavërtetë, parashikuar në Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Kur kishte filluar gjykimi për pikën e dytë të aktakuzës, për veprën penale “Shmangia mashtruese nga taksa e importit”, e parashikuar me nenin 298, par.1, pika 2, e Kodit Doganor dhe i Akcizave, edhe kjo vepër penale kishte arritur parashkrimin absolut më 13 prill 2021.

7. Rasti Artan Avdullahu

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.1677/17

Ngritja e aktakuzës: 14.05.2008

Vepra penale: “Vjedhja e rëndë”

I akuzuar: Artan Avdullahu etj.

Faza e Procedurës: Aktgjykim në shkallë të parë.

Nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **4,950 ditë** apo **12 vite e 11 muaj**.

Ish-prokuroria Publike e Qarkut më 14 maj 2008 kishte ngritur aktakuzë ndaj Artan, Sejdi, Fitim Avdullahu dhe Jeton Sylejmani të cilët i ngarkonte me veprën penale vjedhje e rëndë. Ata janë akuzuar se më 2 mars 2008, në Qendrën Tregtare “Albi Shopping Center”, në

Prishtinë në bashkëkryerje ia kanë marrë pasurinë e luajtshme në vlerë prej 11.700 euro të dëmtuarit Tahir Humolli.

Po ashtu, Artan Avdullahu është akuzuar edhe për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, pasi që i njëjti pas kryerjes së veprës penale të lartcekur në kasetën e rojeve e ka marrë pushkën e gjuetisë dhe një herë ka shtënë në ajër.

Fillimisht ish-Gjykata e Qarkut më 16 shtator 2010, të akuzuarit i kishte shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e rëndë ndërsa Artan Avdullahun edhe për veprën penale për armëmbajtje pa leje.

Mirëpo pasi mbrojtja kishte bërë ankesë, Gjykata Supreme e Kosovës më 18 tetor 2012 këtë çështje e kishte kthyer në rigjykim për veprën penale vjedhje e rëndë. Por, pas kthimit të rastit në rigjykim GjTh në Prishtinë më 6 gusht 2021, të akuzuarin Artan Avdullahu e ka dënuar më 1 vit e 6 muaj burgim ndërsa të akuzuarit tjerë i kishte liruar nga akuza.

8. Rasti Zaim Ilazi

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.1621/14

Ngritja e aktakuzës: 19.02.2008

Vepra penale: “Punimet ndërtimore të kundërligjshme”

I akuzuar: Zaim Ilazi

Faza e Procedurës: Në proces

Nga ngritja e aktakuzës e deri më 1 dhjetor 2021 kanë kaluar **5,039 ditë** apo **13 vite, 9 muaj e 13 ditë**.

Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë më 19 shkurt 2008 ndaj Zaim Ilazit të cilin e ka ngarkuar me veprën penale punimet ndërtimore të kundërligjshme. Ai është akuzuar se më 10 nëntor 2006 në cilësinë e pronarit të firmës ndërtimore “Besimi”, në Fushë Kosovë nuk ka krijuar kushte për sigurinë në punë dhe mbrojtje të shëndetit të punëtorëve ku si shkak i kësaj nga një lartësi prej 12 metra është rrëzuar tani i ndjeri A.B i cili pas lëndimeve të marra kishte vdekur.

Fillimisht ky rast ishte trajtuar në Departamentin për Krime të Rënda, mirëpo me arsyetimin se kjo vepër penale ishte e dënueshme deri në 10 vite burgim, e njëjta ka kaluar në Departamentin e Përgjithshëm.

Kjo lëndë nga gjykatësi Eroll Gashi është pranuar në vitin 2020. Shqyrtimi gjyqësor në këtë rast kishte nisur më 3 nëntor 2021 dhe aktualisht gjykata po procedon me dëgjimin e dëshmitarëve në këtë çështje penale, kur kanë kaluar afro 14 vite nga ngjarja kritike.

9. Rasti Ramiz Kelmendi

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.980/11

Ngritja e aktakuzës: 12.12.2012

Vepra penale: “Vjedhja e shërbimeve komunale”

I akuzuar: Ramiz Kelmendi.

Faza e Procedurës: Aktgjykim refuzues.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit refuzues kanë kaluar **2162 ditë** apo **5 vite, 11 muaj e 1 ditë**.

Sipas aktakuzës së PTh në Prishtinë të 12 dhjetorit 2012, Kelmendi akuzohet për veprën penale “vjedhje e rëndë”, për shkak të dyshimit se prej datës së pavërtetuar e deri më 30 qershor 2011, kompania “Elkos”, në Fushë Kosovë, pronë e Kelmendit ka bërë keqpërdorim të energjinë elektrike.

Prokuroria pretendon se kur punëtorët e KEK-ut kanë shkuar për të bërë kontrole në atë kompani kanë hasur se i pandehuri me qëllim të vjedhjes ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, duke mos regjistruar dy të tretat e energjisë, pasi aty janë gjetur dy transformator të rrymës që kanë qenë jashtë matjes, ndërsa një përcues ishte shkëputur nga lidhja.

Ndryshe, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ishte mbajtur seanca fillestare më 21 dhjetor 2017, kur kishin kaluar më shumë se pesë vite nga ushtrimi i aktakuzës dhe shqyrtimi i dytë më 29 janar 2018, në të cilat Kelmendi e kishte mohuar fajësinë dhe kishte kërkuar nga gjykata që ta hedh aktakuzën ndaj tij. Lidhur me këtë, më 29 janar 2018 gjykata kishte refuzuar kundërshtimet e Kelmendit dhe në këtë mënyrë kishte konfirmuar aktakuzën.

Prokuroria e Apelit kishte dal kundër ish-Prokurorisë Komunale në Prishtinë, ku prokurori i kësaj prokurorie, Enver Sokoli, më 22 shkurt të vitit 2018, i është drejtuar Gjykatës së Apelit, me propozimin që aktakuza ndaj Ramiz Kelmendit të ndryshohet, të hudhet poshtë dhe të pushohet procedura penale, me arsyetimin se në rastin konkret ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale,

Kurse, në bazë të vendimit të 26 shkurtit 2018, të Gjykatës së Apelit, që gjithashtu e kishte siguruar “Betimi për Drejtësi”, kjo gjykatë kishte marrë vendim me anë të së cilit kishte aprovuar ankesën e Kelmendit dhe kishte anuluar vendimin e shkallës së parë, duke e kthyer rastin në rivendosje.

Mirëpo ky proces gjyqësor mori një rrjedhë tjetër në seancën e 12 nëntorit 2018, me ç’rast GjTh në Prishtinë mori aktgjykim refuzues ndaj Kelmendit.

Ky aktgjykim është shpallur pasi paraprakisht, prokurori Blerim Igrishta, ka rikulaifikuar veprën penale ndaj Kelmendit, nga “vjedhje e rëndë”, në “vjedhje të shërbimeve komunale”.

Ky propozim nga prokurori Igrishta, ka ardhur pasi sipas tij, këtë qëndrim e ka dhënë Prokuroria e Apelit, në fazën e kontrollit të aktakuzës, kur lënda ishte në Gjykatën e Apelit.

10. Rasti Gazmend Pula

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.5839/17

Ngritja e aktakuzës: 22.12.2017

Vepra penale: “Asgjësimit apo dëmtimit i pasurisë”

I akuzuari: Gazmend Pula

Faza e Procedurës: Hudhje e aktakuzës.

Nga ngritja e aktakuzës e deri në parashkrimin e ndjekjes penale kanë kaluar **1393 ditë**.

Prokuroria Themelore në Prishtinë më 22 dhjetor 2017, kishte ngritur aktakuzë ndaj Gazmend Pulës për veprën penale “Asgjësimit apo dëmtimit i pasurisë”. Ai po akuzohet se prej 20 gushtit 2017 e deri më 4 tetor 2017, në Prishtinë, me dashje ka dëmtuar pasurinë e të dëmtuarit Daut Shurdha gjatë kohës kur ai nuk ka qenë aty pa lejen e tij i ka prerë një bimë dhe një lajthi të mbjellur në atë pronë para 25 viteve, me ç ‘rast të njëjtit i ka shkaktuar dëm material.

Fillimisht ky rast është trajtuar nga gjykatësi Adnan Isufi, i cili kishte caktuar shqyrtimin fillestar më 19 prill 2019, në të cilën seancë i akuzuari Pula kishte mohuar fajësinë për këtë veprë penale. Shqyrtimi i dytë në këtë rast ishte mbajtur më 23 maj 2019, ku i akuzuari kishte kërkuar hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave. Më pas, KGJK më 21 qershor 2019 kishte miratuar propozimin e Ambasadës Amerikane në Prishtinë që gjykatësi Isufi të ndjek programin Master në SHBA deri në maj 2020. Kjo kishte ndikuar që kjo lëndë ti bartej në punë një gjykatësi tjetër.

Dy vite më pas, më saktë në shtator të vitit 2021 gjykatësi Eroll Gashi kishte filluar të procedojë me këtë lëndë, ashtu që seanca e caktuar më 27 shtator të këtij viti kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së përfaqësuesit të organit të akuzës. Gjatë kësaj seance, ka qenë gjykatësi i rastit ai që ka njoftuar se kjo lëndë arrinte parashkrimin më 19 tetor. Krahas kësaj, ai ka caktuar seancën e radhës për datën 13 tetor, e cila po ashtu kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së të akuzuarit Pula. Në rrethana të tilla, gjykatësi i rastit kishte shtyrë këtë gjykim në kohë të pacaktuar.

ANEX 3. Rastet civile

1. Gjykata Themelore në Pejë

Nr. i lëndës: C.nr.771/17

Paditës: Ibrahim Fazliu

I paditur: Rrustem Berisha dhe Komuna e Pejës

Data e paraqitjes së padisë: 11.10.2000

Paditësi Ibrahim Fazliu në vitin 2000 ka paditur ish-Ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Rrustem Berisha dhe Komunën e Pejës sepse pretendon se kundërligjshëm i është marrë e drejta e shfrytëzimit të pronës në Pejë, me sipërfaqe prej mbi katër ari dhe i është bartur ish-komandantit të UÇK-së dhe ish-ministrit të FSK-së.

Lidhur me padinë e parë, më 19 shtator 2001, ish-Gjykata Komunale në Pejë, nxori aktvendim me të cilin e kishte aprovuar propozimin e të paditurit Rrustem Berisha, për ndërprerjen e procedurës kontestimore. Pas kthimit në rishqyrtim nga ish Gjykata e Qarkut, Ish- Gjykata Komunale në Pejë kishte refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Më pas ish-Gjykata e Qarkut në Pejë, me aktvendim më 11 janar 2006, prishi aktgjykimin e shkallës së parë, duke e kthyer në rishqyrtim. Gjykata Themelore në Pejë më 2 korrik 2017, kishte marr aktvendim, me të cilën kishte hedhur poshtë padinë e paditësit Ibrahim Fazliu si të parregullt për shkak të mos saktësismit të adresës të paditurit Rrustem Berisha. Këtë vendim përsëri e kishte prishur Gjykata e Apelit më 13 korrik 2017. IKD ka gjetur se ky rast është manifestuar me zvarritje të theksuar të procedurës civile, si pasojë e kundërthënieve mes Gjykatave të rregullta, duke bërë lojë “ping-pong” gjykatat mes tyre. Aktualisht rasti gjendet në fazën ankimore sipas mjeteve të rregullta juridike në Gjykatën e Apelit, pasi Gjykata e Pejës më 26 qershor 2020, kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

2. Gjykata Themelore në Pejë

Nr. i lëndës: C.nr.137/18

Paditës: Nushe Loxhaj – Bicaj

E paditur: Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”

Data e paraqitjes së padisë: 18.07.2016

Për aksidentin e ndodhur më 27 janar të vitit 2016 dhe për lëndimet e pësuar nga ky aksident, Nushe Loxhaj -Bicaj dhe familjarët e saj, në korrik të vitit 2016, kishin ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë, dega në Istog, duke kërkuar kompensim dëmi në shumë prej rreth një milion euro.

Lidhur me këtë rast, IKD ka gjetur shkelje ligjore të degës së Gjykatës në Istog, e cila përmes vendimeve joligjore cenuan të drejtën e paditësve në gjykim në kohë të arsyeshme, për shkak të ndërprerjes së kundërligjshme të procedurës dhe mos caktimin e seancës gjyqësore. Lidhur me këtë rast, ish gjykatësi Daut Demiraj kishte ndërprerë procedurën në mënyrë të paligjshme, vendim ky i vili ishte prishur Gjykata e Apelit. Mirëpo edhe përkundër kthimit lëndës në rivendosje, Gjykatësi në Istog nuk kishte bërë caktimin e seancës gjyqësore.

Pra, lidhur me këtë rast IKD gjen se nga ushtrimi i padisë më 18 korrik 2016, e deri në përfundimin e lëndës me vendim të shkallës së parë, kanë kaluar 4 vjet, 2 muaj, 7 ditë, apo 1,530 ditë. Rasti tani gjendet në shkallën ankimore në Gjykatën e Apelit.

3. Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.2424/20

Paditësi: Hysen Morina

I paditur: Korporata Energjetike e Kosovës

Data e paraqitjes së padisë: 18.03.2003

Paditësi Hysen Morina në ish-Gjykatën Komunale në Prishtinë, me 18 mars 2003, kishte ushtruar padi kundër Korporatës Energjetike të Kosovës, nga e cila po kërkon kompensimin e dëmit dhe fitimin e humbur, i shkaktar si pasojë e eksploatimit dhe transportimit të thëngjillit rreth pronës së tij dhe për shkak të rrezikut paditësi nuk ka mundur të jetoj në të. Për këtë rast ish-Gjykata Komunale në Prishtinë me aktgjykimin e datës 04 shkurt 2009, e kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që e ka detyruar KEK-un që në emër të fitimit të humbur t'ia paguaj shumën prej 5,532.00 euro.

Gjykata e Apelit, me 22 qershor 2012, lëndën e kishte kthyer në rigjykim. Pas rigjykimit, GjTh në Prishtinë, me aktgjykimin e datës 21 prill 2017, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Ky vendim përsëri ishte prishur nga Gjykata e Apelit duke e kthyer rastin në rigjykim. Pas analizimit të rastit, IKD gjen se rasti i palëve është duke u vendosur nëpër Gjykata që 17 vite, si pasojë e prishjes së shumtë të vendimeve gjyqësore dhe mosefikasitetin e gjykatës që rasti të kryhet brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Pas analizimit të rastit IKD gjen se, nga ngritja e padisë e deri në marrjen e vendimit për herën e parë e deri në marrjen e aktgjykimi për herën e parë, ish-Gjykata Komunale në Prishtinë iu janë dashur plotë 5 vite e 11 muaj e 1 ditë. Pas 3 viteve 4 muaj, Gjykata e Apelit rastin e ka kthyer në rigjykim. Kurse, që nga kthimi i lëndës në rigjykim e deri në marrjen e vendimit për herën e dytë në shkallë të parë, iu janë dashur plotë 4 vite e 9 muaj e 30 ditë. Lënda përsëri ka shkuar në Gjykatën e Apelit, e cila gjykatë me 24 shkurt 2020 e kishte kthyer lëndën përsëri në rigjykim, pas 2 vjet, 10 muaj, 3 ditë. Që nga kthimi i lëndës në rigjykim e deri në caktimin e seanca e parë përgatitore e më 25 janar 2021, gjykatës iu janë dashur 11 muaj.

4. Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.674/12

Paditësi: Hashim Rexhepi

I paditur: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Data e paraqitjes së padisë: 27.03.2012

Paditësi Hashim Rexhepi në ish-Gjykatën Komunale në Prishtinë më 27 mars 2012, kishte ushtruar padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material në shumë prej 1,953,104.00 euro, për qëndrimin e tij në mënyrë të paligjshme në paraburgim për katër muaj. Në këtë rast që nga ngritja e padisë deri në ditën e caktimit të seancës përgatitore kanë kaluar 7 vjet, 21 ditë edhe pse LPK-ja përcakton afatin 30 ditor.

Në këtë rast që nga seanca e parë përgatitore me 17 prill 2019, e deri në mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor më 9 tetor 2020, kanë kaluar 1 vit, 5 muaj, 22 ditë. Në këtë rast, IKD gjen se gjykata nuk i ka respektuar afatet procedurale të parapara me LPK, dhe për pasojë ka shkaktuar zvarritjen e lëndës përmbi 8 vite. Lidhur me këtë rast, IKD gjen se nga ushtrimi i padisë 27 mars 2012, e deri në përfundimin e tij me aktgjykim të shkallës së parë më 27 tetor 2020, gjykatës iu janë dashur plotë 8 vite, e 7 muaj.

5. Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.1686/11

Paditësi: Ukshin Menxhiqi

E paditur: Komuna e Prishtinës

Data e paraqitjes së padisë: 22.07.2011

Paditësi Ukshin Menxhiqi në GjTh Prishtinë më 22 korrik 2011 ka ushtruar padi për dëmshpërblim në vlerë prej mbi 2 milion euro, për objektin e rrënuar nga Komuna e Prishtinës.

Në padi pretendohet se, paditësit në mënyrë të paligjshme i është rrënuar objekti, dhe Komuna e Prishtinës e kishte urdhëruar paditësin të bëjë largimin e pompave dhe rezervuarve nga nëntoka, me pretendimin se të njëjtat janë të vendosura pa leje, dhe siç thuhet e njëjta nuk kishte marr për bazë se paditësi kishte kërkuar leje dhe e paditura nuk kishte vendosur fare në lidhje me kërkesë e tij. IKD gjen se që nga ngritja e padisë më 22 korrik 2011, e deri në mbajtjen e seancës së parë përgatitore më 20 qershor 2019, kanë kaluar 7 vjet, 10 muaj. Ndërsa, që nga mbajtja e seancës së parë përgatitore, e deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor me 24 nëntor 2020, gjykatës iu janë dashur plotë 1 vit, 5 muaj. Ndërsa nga ushtrimi i padisë më 22 korrik

2011, e deri në marrjen e aktgjykimit me 28 dhjetor 2020, gjykatës iu janë dashur plotë 9 vjet e 5 muaj e 6 ditë.

6. Gjykata Themelore në Pejë

Nr. i lëndës: C.nr.976/15

Paditësi: Ramush Haradinaj

I paditur: Gazmend Muhaxheri

Data e paraqitjes së padisë: 03.11.2015

Paditësi Ramush Haradinaj me 3 nëntor 2015 ka paraqitur padinë për shpifje dhe kompensim të dëmit ndaj kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, me pretendimin se ky i fundit kishte shpifur ndaj tij gjatë një intervistë të dhënë për gazetën austriake “Der Standard”. Në padi thuhet se i padituri Muhaxheri kishte thënë se Haradinaj po bënte para duke kontrolluar biznesin e naftës dhe lojërave të fatit.

Ky rast është manifestuar me zvarritje duke filluar që nga caktimi i seancës përgatitore, për të cilin Gjykata në kuptim të dispozitave të LPK-së detyrohet të mbaj brenda afatit prej 30 ditësh. Në rastin konkret, paditësi ka ngritur padinë në 5 nëntor të vitit 2015, ndërsa seanca përgatitore është mbajtur më 5 qershor 2018, gjegjësisht pas 2 viteve e 7 muajve. Gjykata e Pejës lidhur me këtë padi, ka vendosur më 5 dhjetor 2018. Pas parashtrimit të ankesës nga përfaqësuesi i palës paditëse, kjo lëndë në Gjykatën e Apelit ka mbetur në sirtarë më shumë se 2 vite nga dita e pranimit të saj. Në bazë të përgjigjes zyrtare të Gjykatës së Apelit në shtator të vitit 2021, thuhet se lënda është në pritje për zgjidhje sipas radhës.

7. Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.902/20

Paditësi: Bujar Tafili

I paditur: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Paditësi Bujar Tafili sipas padisë të ushtruar më 12 mars 2008, kërkon nga KGJK-ja kompensimin e dëmit material dhe jo material për qëndrimin e tij në mënyrë të paligjshme në paraburgim dhe arrest shtëpiak nën dyshimin për veprën penale krime lufte kundër popullatës civile dhe fitimin e munguar gjatë kohës së privimit të tij nga liria.

Rasti i lartcekur rezulton të jetë përshkruar në zvarritje të theksuar të procesit kontestimor. Fillimisht kjo padi ishte ngritur në Gjykatë më 12 mars 2008, e precizuar më 17 prill 2008 dhe 22 maj 2013. Pas mbajtjes së tri shqyrtimeve kryesore, GjTh-Prishtinë pas 6 viteve e 7 muaj, e ka aprovuar pjesërisht padinë e paditësit. Kurse pas ankesës, Gjykata e Apelit pas 5 viteve rastin e ka kthyer në rigjykim në GjTh-Prishtinë. IKD vëren se që nga koha e ngritjes së padisë e deri në vendimin e Apelit me të cilin rasti është kthyer në rigjykim, kanë kaluar 11 vite e 11

muaj. Kjo lëndë pas kthimit të rastit në rigjykim, në shkallë të parë ka përfunduar më 26 korrik 2021.

8. Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.2708/09

Paditësi: Adelina Rama-Maxhuni

I paditur: Iber Lepenci

Data e paraqitjes së padisë: 7.12.2009

Përmes padisë të ngritur në dhjetor të vitit 2009, paditësja Adelina Rama-Maxhuni ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimin mbi shfuqizimin e kontratës të lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës “Iber Lepenci”, kthimin e saj në punë dhe kompensimin e pagave të papaguara.

Pas 5 viteve e 6 muaj nga ngritjes së padisë, GjTh-Prishtinë kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditëses për kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e pagave. Ky vendim ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit në pjesën që paditësja të kthehet në vendin e punës së mëparshëm. Kurse e ka kthyer çështjen në rigjykim për kompensimin e pagave. Procedura kontestimore pas kthimit të rastit në rigjykim vetëm për kompensimin e pagave ka vazhduar deri më 29 prill 2021, në të cilin GjTh-Prishtinë e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses. IKD vëren se që nga ngritja e padisë deri në vendimin e Gjykatës Supreme përkitazi me kërkesën për kthimin në vendin e punës kanë kaluar 8 vite e 6 muaj.

9. Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.1352/10

Paditësi: Bujar Vrapçi

I paditur: BKS

Data e paraqitjes së padisë: 16.06.2010

Paditësi Bujar Vrapçi ka paditur Byronë Kosovare të Sigurimeve për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, si pasojë e një aksidenti të trafikut më 14 shkurt 2010.

IKD ka vërejtur se rasti i paditësit gjendet në sirtarët e Gjykatave të rregullta gati një dekadë dhe ende nuk ka marrë përfundim as pas 10 viteve. Fillimisht paditësi ka paraqitur padi më 16.06.2010, kurse GjTh- Prishtinë për këtë rast ka vendosur pas 4 vite e 11 muaj. Kur rasti kishte shkuar në Gjykatën e Apelit sipas ankesës të paditurit, në këtë instancë ishte vendosur pas 4 viteve e 9 muaj, me të cilin, Apeli më pas e kishte kthyer në rigjykim rastin për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore. IKD vëren se edhe pas 10 viteve ky rast është

duke u trajtuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë në rigjykim, ku seanca e caktuar me 21 tetor 2021, nuk ishte mbajtur. Ky rast gjendet ende në procedurë në shkallë të parë.

10. Gjykata Themelore në Pejë

Nr. i lëndës: C.nr.190/17

Paditësi: Shoqata Komunale e të Verbërve në Istog

I paditur: Sadri Nicaj

Data e paraqitjes së padisë: 05.01.2006

Para 14 vitesh Shoqata Komunale e të Verbërve në Istog kishte nisur betejën ligjore përmes ushtrimit të padisë në ish-Gjykatën Komunale të Istogut ndaj të paditurës Have Nicaj, duke kërkuar që e paditura të liroj hapësirën dy dhomëshe, të cilën sipas paditëses e paditura e kishte uzurpuar Kjo paluajtshmëri në të cilën po kërkohet lirimi i saj, sipas Shoqatës së të Verbërve, është në funksion të pushimores të personave të verbër e që mbi 35 vite ishte uzurpuar nga e paditura Have Nicaj, ndërsa pas vdekjes së saj, në cilësinë e të paditurit është përfshirë Sadri Nicaj.

IKD në këtë rast ka gjetur se nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë janë marrë më shumë se pesë vendime gjyqësore kundërthënëse, duke kthyer rastin në rivendosje, të cilat shkaktuan një zvarritje mbi 15 vite të procesit kontestimor. Zvarritja e procedurës nuk ka ndodhur as për shkak të kompleksitetit të çështjes, apo numrit të lartë të provave, apo zvarritja nuk mund t'i atribuohet sjelljes së palëve, për arsyeje se gjykata disa herë ka dështuar të vendos ligjërisht për themelësinë e kërkesëpadisë. Ky rast është manifestuar edhe me kthim të shpeshtë të rastit në rigjykim. Me 26 qershor 2020, Gjykata e Pejës ka vendosur në mënyrë meritorë për këtë rast, ndërsa tani lënda gjendet në Gjykatën e Apelit.